



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

RAPORT AUDITIMI NË INSTITUCIONI E PREFEKTIT TË QARKUT LEZHË

Qershor 2017.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 255/1, datë 13.03.2017, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.12.2016.

Auditimi është kryer nga;

1. Q. Sh, përgjegjës grupi,
2. P. Gj., auditues,
3. V. S., auditues,
4. B. B., auditues.

PERMBAJTJA

	Faqe
Përmbledhje	2-8
Hyrje	8-10
Qëllimi dhe procesi i auditimit	10
1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.....	10-11
2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.....	11-12
3 Hartimin dhe zbatimin e buxhetit	12-14
4. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës.....	14-18
5. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit. Nxjerrja e Pasqyrave Financiare..... ..	18-24
6. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime e shërbime	24-30
8. Auditim mbi funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të titujve të pronësisë.....	30-94
9 .Të ndryshme të dala gjatë auditimit..... ..	94
Konkluzionet dhe Rekomandimet	95-104

PERMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi në Institucioni e Prefektit të Qarkut Lezhë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike dhe komisionin e vlerësimit të titujve të pronësisë. Gjatë auditimit të aktivitetit të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016, në mënyrë të përmbledhur rezulton si më poshtë:

Më poshtë po Ju paraqesim gjetjet kyçe nga auditimi:

- Komisioni vendor për verifikimin e titujve të pronësisë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, procesverbalin e mbledhjeve nuk e ka mbajtur në një libër të sekretuar me numër fletësh të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës, por procesverbali është mbajtur në fletë të shkëputura për çdo vendim të marra sipas ankesave, kërkesave, informacioneve të paraqitura nga shtetas dhe strukturat shtetërore dhe nga kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet. Në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

procesverbal **nuk janë regjistruar problemat e trajtuar nga relatori i çështjes, nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni**, veprim në papajtueshmëri me nenin 16 pika 4, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“ dhe germën **a, b** pika 6, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për **6 vendime me sipërfaqe 37346 m², nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë**, ndaj anëtareve të komisioneve të ndarjes së tokës të fshatrave, pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, të cilat kanë sjellë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **32** vendime të marra, nuk ka hartuar informacionin përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara në lidhje me vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **7 vendime me sipërfaqe 37346 m²**, nuk ka marrë në dorëzim tokën bujqësore të liruar që përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfutur në kundërshtim me ligjin, si dhe këtë sipërfaqe toke bujqësore nuk e kanë dorëzuar me procesverbal në Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Lezhë (DAMT), veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **32 raste**, nuk ka bërë inventarizimin e dosjeve, si dhe nuk ka përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

- Komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, në **33 raste** shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore i ka bërë jashtë afatit ligjor, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për **5 vendime** nuk ka kërkuar konfirmim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, përfutuesit e tokës bujqësore me datë 01.08.1991, kanë qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 kanë qenë punonjës të ish-NB-së, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin.”.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim **nr. 108, datë 02.09.2013**, ka bërë korigjimin e AMTP nr. 17, datë 01.02.1992, duke kaluar në pronësi të Gj. L. pasurisë nr. 19/12-A me sipërfaqe **1050 m²** tokë bujqësore, pasi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Qarku Lezhë, nuk është kthyer përgjigje nëse Gj. D. L., ka qenë punonjës në ish-kooperativën bujqësore apo në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, **që ka sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me **vendim nr. 137, datë 18.10.2016**, në AMTP nr. 8971, datë 28.07.1996, lëshuar në emër të V. L. H., fshati Ishull-Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, **në zërin kadastral truall me sipërfaqe 200 m²**, veprim në papajtueshmëri me veprim në papajtueshmëri me germën a neni 1, të ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar dhe nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me **vendim nr. 137, datë 18.10.2016**, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin nga V. L. H., fshati Ishull-Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, arkëtimin e vlerës **393,813 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë **në pikën 2 të vendimit nr. 140, datë 05.11.2016**, për pasurinë nr. 13/36 A me sipërfaqe 5728 m² përfituar më shumë se norma për frymë që kalon në pronësi shtet, duhet të ishte shprehur për AMTP nr. 10133, datë 01.06.1995, fshati Tale 1, në ndërsa për AMTP nr. 14473, datë 21.01.2002, duhet të ishte shprehur fshati Grykë Lumi, veprim në papajtueshmëri me nenin 8, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, si dhe për sipërfaqen 100 m² i cili me datë 01.08.1991, ndodhet në zërin kadastral “Truall”.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me **vendim nr. 140, datë 11.05.2016**, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin nga Gj. K. N., fshati Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, arkëtimin e vlerës **627,000 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. **125, datë 12.03.2015**, nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin nga D.C., fshati Grykë Lumi, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, për arkëtimin e vlerës **1,343,000 lekë**;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

- me vendim nr. **126, datë 12.03.2015**, nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfutur në kundërshtim me ligjin nga M. P. L., fshati Ishull-Lezhë, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, për arkëtimin e vlerës **3,439,028 lekë**;
- me vendim nr. **126, datë 12.03.2015**, nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfutur në kundërshtim me ligjin nga V. P. L., fshati Grykë Lumi, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, për arkëtimin e vlerës **3,443,926 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Komisioni vendor me **vendim nr. 104, datë 29.05.2013**, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997 me sipërfaqe 17981 m² lëshuar në emër të T. P. Gj., fshati Grykë Lumi, ndërsa ZVRPP Lezhë ka konfirmuar se për këto pasuri KLSH ka rekomanduar kufizimin e tyre. AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 17981 m² pasi ka përfutur më shumë tokë bujqësore me sipërfaqe **5081 m²**, duke i llogaritur si tokë me bonitet të ulët, ndërsa këto toka nuk ndahen pasi janë toka pa fryt (PF), ndërsa komisioni vendor duhet të vendoste pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 17981 m², veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Komisioni vendor me **vendim nr. 111, datë 29.05.2013**, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14691, datë 22.01.2001, me sipërfaqe **3000 m²** pasi familja e F. P. është pajisur me tokë bujqësore në zbatim të VKM nr. 306, datë 30.06.1994 “Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i Hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”, përfutur më shumë se norma për frymë **750 m²**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Komisioni vendor me **vendim nr 112, datë 11.07.2013** ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 13887, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 8011 m² lëshuar në emër të N. Rr. Gj., me vendim nr. 113, datë 11.07.2013, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14690, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të G. P.F., fshati Grykë Lumi, dhe me vendimin nr. 118, datë 09.09.2013 ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14689, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; lëshuar në emër të N. D. D., fshati Grykë Lumi, pasi në dosje mungon dokumentacioni tekniko ligjor, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”.
- Komisioni vendor me **vendim nr. 114, datë 26.08.2013**, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997, me sipërfaqe **11500 m²**, lëshuar në emër të T. Ll. J., fshati Grykë-Lumi, ndërsa ZVRPP Lezhë ka konfirmuar se për këto pasuri KLSH ka kufizuar këto pasuri. Me AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 11500 m² T. Ll. J., ka përfutur më shumë tokë bujqësore me sipërfaqe **4100 m²**, duke i llogaritur si tokë me bonitet të ulët, ndërsa këto toka nuk ndahen pasi janë toka pa fryt (PF), ndërsa komisioni vendor duhet të vendoste pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 11500 m², veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

- Komisioni vendor me **vendim nr. 119, datë 07.02.2014**, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m², lëshuar në emër të R. Gj. Gj. (M.), fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, pasi kjo familje ka përfituar tokë bujqësore më shumë **221 m²**, duke i llogaritur si tokë me bonitet të ulët, ndërsa këto toka nuk ndahen pasi janë toka pa fryt (**PF**), ndërsa komisioni vendor duhet të vendoste pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m², veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Komisioni vendor me **vendim nr. 120, datë 07.02.2014**, ka vendosur rikonfirmimin e nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe **44900 m²**, lëshuar në emër të N. P. L., fshati Barbullonjë, Komuna Shënkoll, pasi me shkresë nr. 717, datë 26.12.2013 Komuna Shënkoll konfirmon se familja e N.P. L. me datë 01.08.1991, është 9 frymë dhe certifikata është lëshuar nga zyra e gjendjes civile Rrëshen, pra kjo familje nuk është banore e Komunës Shënkoll. Komisioni vendor nuk duhet të kishte marrë vendim për rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe **44900 m²** por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP, pasi N. P. L. nuk kanë qenë banorë i këtij fshatit, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Komisioni vendor me **vendim nr. 123, datë 06.10.2014**, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe **5003 m²**, lëshuar në emër të L. Gj. N., fshati Grykë-Lumi, Komuna Shënkoll, duke përfituar më shumë se norma për frymë një sipërfaqe prej **1303 m²**. Komisioni vendor duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe **5003 m²**, pasi L. Gj. N. me datë 01.08.1991 nuk ka qenë anëtare e ish-kooperativës bujqësore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, ka konfirmuar se Lindita Ndoj, ka punuar në NFP Rubik sektori Grykë-Lumi, Tale nga data 01.08.1989 deri me datë 31.12.1991, si dhe Zyra e Gjendjes Civile Shënkoll, me shkresë nr. 218, datë 09.08.2014, konfirmon se L. N. është vendosur në Komunën Shënkoll fshati Grykë-Lumi me datën 05.04.2002, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Komisioni vendor në ish-NB dhe në zonat me përparësi turizmi për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datë 31.12.2016, nuk ka marrë asnjë vendim në lidhje me kontrole të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë ka tejkaluar numri me **2** punonjës në lidhje me organikën e komisionit vendore të shqyrtimit të titujve të pronësisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kreu III, pika 4, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Janë konstatuar shkelje në lidhje me rekrutimin e punonjësve në punë pa zhvilluar procesin e rregullt ligjor të konkurrimit, e konkretisht është emëruar me aktin e emërimit nr. 53, datë 30.06.2014 deri më 01.09.2016 e emëruar përgjegjëse e sektorit juridik. Gjithashtu, janë kryer pagesa për vendime të Gjykatës së Apelit pa bërë Rekurs në Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, veprim në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

papajtueshmëri me pikën **iii** shkronja **a** neni 9, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

- Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë ka kryer pagesa në shumën **212,400 lekë**, për riparime dhe shërbime automjeti e kryer me procedurë blerje me vlera të vogla, duke i trajtuar si raste emergjente duke shkelur Udhëzimin e AP nr. 3, datë 27.01.2014 “Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël” pika 7, pasi kanë kaluar vlerën prej 100,000 lekë, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e blerjeve të vogla.

- Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të **menaxhimit financiar dhe të kontrollit**, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), nuk ka realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe nuk është formuluar deklarata e vizionit dhe misionit të njësisë në të cilën përcaktohen objektivat strategjike afatgjatë, veprim në papajtueshmëri me neni 8 dhe 21, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

- Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e Brendshme në zbatim të Urdhrit nr. 13, datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Lezhë”, pasi Rregullorja e Brendshme që është në funksionim është miratuar në vitin 2010 dhe nuk i përshtatet strukturës dhe organikës aktuale të institucionit, veprim në papajtueshmëri me nenin 22, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

- Për vitin 2015 janë zhvilluar dy procedura prokurimi me vlerë 1,538,750 lekë pa tvsh për: “Rikonstruksionin e zyrave të prefekturës” dhe me një vlerë 416,666 lekë pa tvsh për: “Blerje karburanti”, me procedure prokurimi “Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. **Në dosjet e tenderit nuk gjenden dokumente për përlogaritjen e fondit limit, si dhe nuk gjendet procesverbal i mbajtur nga njësia e prokurimit për këtë qëllim**, veprim në papajtueshmëri me neni 12, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 33, datë 11.07.2013 të Ministrisë së Financave “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë.

- Përzgjedhja e procedurës së prokurimit për blerje karburanti nuk është e arsyetuar dhe e dokumentuar si emergjente dhe ka sjellë që fondet buxhetore të PMNZSH të shpenzohen në kundërshtim me principet e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit të fondeve publike, pasi përdorimin e fondeve publike, kursimi i tyre, trajtimi i barabartë i operatoreve pjesëmarrës kanë bërë që vlera **416,666 lekë** (pa tvsh), në papajtueshmëri me nenin 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar .

- Nga 14 masa organizative të lëna nga KLSH, janë zbatuar **13 masa** dhe në proces zbatimi **1 masë** për arkëtim e shumës **63,292 lekë** nga D. L. në shumën **30,885 lekë**, N. L. në shumën **9,144 lekë**, A. R. në shumën 13,067 lekë dhe K. R. në shumën 43,112 lekë.

- Sektori i financës në Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë për vitin 2016 ka kryer pagesë për shpenzime për larje mjete jashtë funksionimit, pasi nuk ka leje qarkullimi dhe targa, pra është jashtë funksionimit në shumën **35,200 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, veprim në papajtueshmëri me neni 2, të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe pikën 10, të UMF nr. 30, datë 27.12.2013 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

- Nga zbatimi i kontratës së punimeve në fakt në tenderin me vlerë 1,538,750 lekë pa tvsh për: “Rikonstruksionin e zyrave të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë”, janë konstatuar diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **38,317 lekë** pa tvsh nga subjekti “Kthjella” shpk, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në kundërshtim me kontratë nr. 590, datë 30.03.2015 dhe prventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

Nisur nga zbulimet e gjetura nga ky auditim ne rekomandojmë: 26 masa organizative dhe masa shpërbllim dëmi 2 (të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi).

Hyrja

KLSH auditoi **Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë**, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike dhe komisionit vendor të vlerësimit ligjor të titujve të pronësisë, etj.

Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes siguria e nivelit të menaxhimit si dhe transparenca me publikun.

Objektivat kryesore për këtë çështje kanë qenë: Që nëpërmjet një pune audituese sistematike dhe me zgjedhje të evidentohen shkeljet dhe parregullsitë si në drejtim të transaksioneve financiare ashtu dhe në zbatimin e procedurave ligjore nga strukturat e subjektit të audituar me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës për të ardhmen si dhe për të bërë të mundur që menaxherët e lartë të në Institucioni e Prefektit të Qarkut Lezhë, të kuptojnë nevojën e domosdoshme të një strukture kompetente dhe me pavarësi optimale të Auditit të brendshëm e cila do të bënte të mundur evidentimin në kohë të mangësive e shkeljeve me qëllim marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë për përmirësimin e gjendjes.

Përshkrimi i çështjes që auditohet: Auditim mbi zbatimin e detyrave të lëna në auditimet e mëparshme. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, në përputhje me disiplinën financiare. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime. Auditim mbi funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të titujve të pronësisë etj, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 225/1, datë 13.03.2017, të miratuar nga Kryetari i KLSH.

Në përputhje me: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të e Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”; Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të e Lartë të Shtetit”; Ligj nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar; ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar; Ligj nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”; Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërbllim, të tokës bujqësore”, të ndryshuar; Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar; Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

informimit për dokumentet zyrtare”, të ndryshuar; Ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar; Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, të ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligji nr. 7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar; VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar; VKM nr. 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)”; VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar; VKM nr. 567, datë 05.09.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave, përcaktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik”, VKM nr. 868, datë 18.06.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”, kur toka bujqësore e liruar rezulton me prejardhje nga ish-ndërmarrjet bujqësore (NB), sipas gjendjes më 01.10.1992, VKM nr. 230, datë 22.07.1991 “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar, UMB nr. 106, datë 23.02.1996 “Për procedurat e kalimit të tokës nga përdorimi në pronësi”, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”; VKM “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” sipas viteve përkatëse të auditimit; Ligjet për Buxhetin, VKM dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave në lidhje me vitin buxhetor, objekt auditimi; Ligji nr. 10294, datë 01.7.2010 “Për inspektimin financiar”; Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Urdhër për miratimin e Manualit për MF dhe Kontrollin me nr. 8980, datë 15.7.2010; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet, lejet në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 9869, datë 4.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 35, datë 05.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008”; ligji nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësit Civil” dhe VKM e Udhëzimet e KM e DAP për zbatimin e këtij ligji; VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”; Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”; Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligji nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i APP nr. 1, datë 20.3.2007 “Për blerjet me vlera të vogla”, i ndryshuar; VKM nr. 914, date 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat caktimin pagave e të shpërblimeve”; VKM nr. 472, datë 02.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, VKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve ndërtimit”; Ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, i ndryshuar; VKM nr. 1129, datë 5.08.2008 “Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit, të vënë nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit”; VKM nr. 529, datë 8.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë të pasurive shtetërore”; VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë të pasurive shtetërore”; Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” i ndryshuar; Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Akte të tjera ligjore dhe nënligjore për çështje të trajtuara gjatë procesit të auditimit të cilat nuk janë parashikuar më sipër.

Gjendja aktuale e çështjes së shqyrtuar: Është në fazën kur është hartuar dhe dërguar në subjektin e audituar për njohje e vërejtje Projektraporti i Auditimit.

Objektivi kryesor i subjektit të audituar: Është menaxhimi me transparencë, economicitet, efikasitet dhe efektivitet i buxhetit vendor, kryerja e funksioneve dhe aktiviteteve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Qëllimi dhe procesi i auditimit:

Subjekti i audituar: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

Çështjet e audituara:

1. Auditim mbi zbatimin e detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.
2. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.
3. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.
4. Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës.
5. Rregullariteti i veprimeve nëpërmjet arkës e bankës në përputhje me disiplinën financiare.
6. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.
7. Auditim mbi funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të titujve të pronësisë.
8. Probleme të ndryshme

Objektivat e auditimit: Zbulimi i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, Ligjshmërisë, Efiçensë, Efektivitetit dhe Economicitetit të menaxhimit financiar me qëllim që për rastet individuale të identifikuar të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Kriteret e vlerësimit: Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{së}, pasi u njoh me bazën ligjore e nënligjore dhe Vendimet e Prefektit të Qarkut, mbi të cilën Institucioni i Prefektit ushtron aktivitetin e tij, si dhe duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit vendor, në hartimin, miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike, etj, *ku grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit.*

1. Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Auditimi i zbatimit rekomandimeve të dërguara nga KLSH, bëhet bazuar në programin e auditimit me nr. 255/1, datë 13.3.2017. Rekomandimet nga auditimi, janë dërguar nga KLSH-ja Prefektit të Qarkut Lezhë sipas shkresës me nr. 118/5, datë 14.6.2010 ”Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresë nr. 891/1, datë 30.06.2010 ka kthyer përgjigje në lidhje me rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtarë të KLSH, duke hartuar program pune nga Sektori i Auditit dhe Financës.

Nga 14 masa organizative janë zbatuar **13 masa** dhe është në proces zbatimi një masë për arkëtim e shumës 63,292 lekë nga D. L. në shumën 30,885 lekë, N. L. në shumën 9,144 lekë, A. R. në shumën 13,067 lekë dhe K. R. në shumën 43,112 lekë.

2. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Prefektura e Lezhës ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në zbatim të nenit 8, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, për periudhën nga Janari i vitit 2013 - deri në fund të vitit 2016.

Plani për ngritjen e sistemit menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjia për zbatimin e tij.

Titullari i Prefekturës së Lezhës i cili përgjigjet për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë që drejton, në zbatim të nenit 8, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në zbatim të nenit 8, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Në zbatim të nenit 8/2, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nga titullarët e Institucionit të Prefektit Lezhë për vitin 2013, 2014, 2015 është caktuar “Nëpunës Zbatues” për institucionin S. F. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës, dërguar pranë degës së Thesarit me shkresë nr. 29, datë 30.07.2016 dhe konfirmuar nga Ministria e Financave.

Për vitin 2016, institucionit i Prefektit Lezhë ka caktuar ka caktuar “Nëpunës Zbatues” për institucionin S. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me shkresë nr. 9109, datë 01.07.2016. Gjithashtu janë caktuar “Nëpunës Autorizues” ish Titullarët dhe Titullari aktual të cilët janë konfirmuar dhe nga Ministria e Financave në zbatim të kërkesave të nenit 19 të ligjit nr.9936, datë 26.02.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, dhe të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, për periudhën objekt auditimi janë ngritur dhe kanë funksionuar sipas dispozitave ligjore grupi për menaxhimin strategjik (GMS).

Deklarata e Vizionit dhe Misionit e njësisë, në të cilën të jenë përcaktuar objektivat startegjikë afatgjatë për institucionit nuk është bërë, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Mbikqyrja e e vendimeve dhe veprimeve të nëpunësit zbatues. Nga nëpunësit zbatues i njësisë janë përcaktuar rregulla për nënshkrimin e dokumentave financiare sipas rregullores së miratuar nga Titullari. Kjo ka forcuar sistemin e kontrollit të pagesave nëpërmjet dy nënshkrimeve, i cili nuk ka lejuar që pagesat të kryhen pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë. Kjo i ka mundësuar nëpunësit zbatues të sigurojë mbrojtjen e aktiveve të njësisë, të sigurojë monitorimin e dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe të veprimtarive që lidhen me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

mbarëvajtjen e njësisë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave. Për rastet e parregullsive nuk u konstatua dokumentimi i tyre, nga nëpunësit e ngarkuar, në kundërshtim me nenin 23/6, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010.

Risku dhe menaxhimi i tij.

Nga auditimi rezulton se në institucion në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi në institucion u evidentuan se për vitet 2013,2014 dhe viti 2015 është hartuar rregjistri i riskut në institucion . .

3. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Zyra e Financës në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, ka hartuar treguesit e buxhetit **për vitin 2013** dhe në bazë të shkresës nr. 889, datë 05.02.2013 “Për detajimin e buxhetit të vitit 2013” të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMB nr. 163, datë 20.03.2009 “Për zbatimin e Buxhetit në Sistemin e Ministrisë së Brendshme” ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e Vitit 2013”, për hartimin e buxhetit sipas zërave të shpenzimeve për aparat, Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH) dhe Gjendjen Civile, janë ngritur grupet e punës dhe ka dërguar strukturën buxhetore

Shpenzimet për aparat, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, shpenzimet e transporti dhe investimet janë planifikuar 35,219 mijë lekë, janë realizuar 34,149 mijë lekë, nuk janë realizuar 1,070 mijë lekë ose 97 % e tyre. Mosrealizimi i paga ka ardhur nga pozicionet e punës së punonjësve të aparatit të institucionit të Prefektit, si dhe nga mosplotësimi i vendeve vakante për strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Shpenzimet për PMNZSH, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet e transporti janë planifikuar 39,885 mijë lekë, janë realizuar 39,793 lekë, nuk janë realizuar 92 mijë lekë ose 99.7 % e tyre. Mosrealizimi i paga ka ardhur për faktin e mos shoqërimit me efekte financiare në rritjen në gradë të punonjësve të PMNZSH-së, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Shpenzimet për Gjendjen Civile, pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative janë planifikuar 2,707 mijë lekë, janë realizuar 2,706 lekë, nuk janë realizuar 1 mijë lekë ose 100 % e tyre.

Për vitin 2014 në bazë të shkresës nr. 8556/12, datë 17.01.2014 “Për detajimin e buxhetit të vitit 2013” të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, ligjin nr. 185/2013, datë 17.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014”, për hartimin e buxhetit sipas zërave të shpenzimeve për aparat, Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH) dhe Gjendjen Civile, janë ngritur grupet e punës dhe ka dërguar strukturën buxhetore.

Shpenzimet për aparat, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, shpenzimet e transporti dhe investimet janë planifikuar 45,818 mijë lekë, janë realizuar 43,536 lekë, nuk janë realizuar 2,281 mijë lekë ose 95 % e tyre. Mosrealizimi i paga ka ardhur nga pozicionet e punës së punonjësve të aparatit të institucionit të Prefektit, si dhe nga mosplotësimi i vendeve vakante për strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Shpenzimet për PMNZSH, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet e transporti janë planifikuar 45,342 mijë lekë, janë realizuar 44,808 lekë, nuk janë realizuar 534 mijë lekë ose 99 % e tyre. Mosrealizimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

paga ka ardhur për faktin e mos shoqërimit me efekte financiare në rritjen në gradë të punonjësve të PMNZSH-së, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe shpenzimet operative. Shpenzimet për Gjendjen civile, pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative janë planifikuar 2,770 mijë lekë, janë realizuar 2,764 lekë, nuk janë realizuar 7 mijë lekë ose 100% e tyre. Mosrealizimi për pagat e Gjendjes Civile ka ardhur nga mos plotësimi i vendeve vakante në strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për vitin 2015, me shkresën 10532/2, datë 09.01.2015 “Dërgohet Buxheti i Miratuar për vitin 2015”, bbazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde te zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brëndshme”, ligjin nr. 160/2014, datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e Vitit 2015” për hartimin e buxhetit sipas zërave të shpenzimeve për aparatit, Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH) dhe Gjendjen Civile, janë ngritur grupet e punës dhe ka dërguar strukturën buxhetore.

Shpenzimet për Aparatin, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, shpenzimet e transporti dhe investimet janë planifikuar 37,145 mijë lekë, janë realizuar 34,408 lekë, nuk janë realizuar 2,736 mijë lekë ose 92.6 % e tyre. Mosrealizimi i paga ka ardhur nga pozicionet e punës së punonjësve të aparatit të institucionit të Prefektit, si dhe nga mosplotësimi i vendeve vakante për strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Shpenzimet për PMNZSH, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative dhe shpenzimet e transporti janë planifikuar 44,926 mijë lekë, janë realizuar 44,685 lekë, nuk janë realizuar 240 mijë lekë ose 99 % e tyre. Mosrealizimi i paga ka ardhur për faktin e mos shoqërimit me efekte financiare në rritjen në gradë të punonjësve të PMNZSH-së, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Shpenzimet për Gjendjen civile, pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative janë planifikuar në shumën 2,807 mijë lekë, janë realizuar 2,772 lekë, nuk janë realizuar 34 mijë lekë ose 94 % e tyre. Mosrealizimi për pagat e Gjendjes Civile ka ardhur nga mos plotësimi i vendeve vakante në strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për vitin 2016, me shkresën 131/4, datë 14.01.2016 “Dërgohet Buxheti i Miratuar për vitin 2016”, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde te zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brëndshme”, Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016”, për hartimin e buxhetit sipas zërave të shpenzimeve për aparatit, Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH) dhe Gjendjen Civile, janë ngritur grupet e punës dhe ka dërguar strukturën buxhetore.

Shpenzimet Aparatin, pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, shpenzimet e transporti dhe investimet janë planifikuar 32,627 mijë lekë, janë realizuar 30,994 lekë, nuk janë realizuar 1,633 mijë lekë ose 95 % e tyre. Mosrealizimi i paga ka ardhur nga pozicionet e punës së punonjësve të aparatit të institucionit të Prefektit, si dhe nga mosplotësimi i vendeve vakante për strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gjatë vitit 2016 janë bërë shpenzime vetëm për transferime të brendshme për familjet në shumën 955 mijë lekë, pasi Policinë e Mbrojtjes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH) ka kaluar në vartësi të Bashkive. Shpenzimet për Gjendjen civile, pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative janë planifikuar në shumën 2,807 mijë lekë, janë realizuar 1,911 lekë, nuk janë realizuar 896 mijë lekë ose 68 % e tyre. Mosrealizimi për pagat e Gjendjes Civile ka ardhur nga mos plotësimi i vendeve vakante në strukturën, duke mos realizuar edhe fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Analizë e detajuar e shpenzimet operative llogaria 602.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve operative për Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë, për periudhën objekt auditimi u konstatua se shpenzimet operative llogaria 602, janë planifikuar dhe realizuar: për vitin 2013, shpenzimet operative janë realizuar në masën 100% e tyre, për vitin 2014 shpenzimet nuk janë realizuar në shumën 935 mijë lekë ose 94% e tyre, për vitin 2015 nuk janë realizuar në masën 100% e tyre, për vitin 2016 nuk janë realizuar në shumën 859 mijë lekë, ose 87% e tyre.

Mos realizimi i shpenzimeve për vitin 2014 dhe vitin 2016, tregon për një planifikim jo të drejtë të fondeve buxhetore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, veprim në papajtueshmëri me germen a dhe b neni 2, germen b neni 19, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

b - Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve operative për PMNZSH, për periudhën objekt auditimi u konstatua se shpenzimet operative llogaria 602, janë realizuar në masën 100 %

Planifikimin dhe realizimin i pagave për vitin 2013, 2014, 2015 dhe 2016

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, për vitin 2013, pagat nuk janë realizuar në shumën 425 lekë ose 98 %, sigurimet shoqërore nuk janë realizuar në shumën 645 lekë ose 86% e tyre, për vitin 2014 pagat nuk janë realizuar në shumën 398 lekë ose 98 % e tyre, sigurimet shoqërore nuk janë realizuar në shumën 718 lekë ose 84% e tyre, për vitin 2015 pagat nuk janë realizuar në shumën 2,394 lekë ose 90 % e tyre, sigurimet shoqërore nuk janë realizuar në shumën 338 lekë ose 91% e tyre dhe për vitin 2016 pagat nuk janë realizuar në shumën 667 lekë ose 97 % e tyre, sigurimet shoqërore nuk janë realizuar në shumën 108 lekë ose 97% e tyre. Për PMNZSH, për periudhën objekt auditimi, pagat janë realizuar masën 100 %, sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 98 % e tyre. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se të ardhurat janë realizuar: për vitin 2013 në shumën 734 mijë lekë, për vitin 2014 në shumën 758 mijë lekë dhe për vitin 2015 në shumën 819 mijë lekë .

4. Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës.

Struktura dhe organika në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për vitin 2013 deri në fund të vitit 2016 përfshin aparatit e Prefektit Lezhë, nënprefekturat Kurbin dhe Mirditë dhe Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë funksionon në bazë të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin” deri në vitin 2016, i ndryshuar me ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”. Struktura dhe organika dhe niveli i pagës për administratën e institucionin për periudhën objekt auditimi bazohet në:

Pasqyra e numrit të punonjësve, për institucionin e Prefektit paraqitet si më poshtë;

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”**

Vitet		Numri i Punonjësve							
		Plan				Fakt			
		Gjithsej	Staf Politik	Me Status nepunesi Civil	Me Kod PUNE	Gjithsej	Staf Politik	Me Status nepunesi Civil	Me Kod PUNE
2013		33	3	0	30	32	3	0	29
2014		33	3	20	10	32	3	20	9
2015		33	3	20	10	32	3	20	9
2016	01.01-30.04.	33	3	20	10	32	3	20	9
	01.05-31.12.	31	3	20	8	31	3	15	10
Vende vakante								5	

Në 000/lekë

Fondi i pagave, sigurimeve shoqërore & shëndetësore						
Vitet	Llog. 600 Fondi i Pagave			Llog. 601 Fondi i sigurimeve shoqërore & shëndetësore		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
2013	24,125	23,700	98	4,525	3,880	86
2014	23,475	23,077	98	4,595	3,827	83
2015	24,500	22,106	90	4,015	3,677	91
2016	21,392	20,725	97	3,545	3,437	97

II. Arkivi i Gjendje Civile Lezhë, Kurbin dhe Mirditë.

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë funksionon dhe Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile pranë administratës së institucionit dhe në nënprefekturën Kurbin dhe Mirditë, në kuadrin e funksioneve të deleguara në zbatim të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, neni 16-Kontrolli i përgjegjësive të deleguara deri në vitin 2016, i ndryshuar me ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 18.

Struktura dhe organika dhe nivele i pagave për arkivin e gjendjes civile në administratën e Prefektit dhe në rrethet Kurbin dhe Mirditë, bazohet në:

Struktura dhe organika e gjendjes civile deri në vitin 2009 ka qenë pjesë e organikës së Urdhrit nr. 57, datë 10.04.2006, dhe në vitin 2010 është strukturë buxhetore në vete e cila financohet me fondet e Ministrisë së Brendshme.

Pasqyra e numrit të punonjësve, për arkivin e gjendjes civile institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, Kurbin dhe Mirditë paraqitet si më poshtë vijon:

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT
TE QARKUT LEZHE”**

Vitet	Numri i Punonjësve					
	Plan			Fakt		
	Gjithse j	Me Status nepune si Civil	Me Kod Pune	Gjithse j	Me Status nepune si Civil	Me Kod Pune
2013	3	0	3	3	0	3
2014	3	3	0	3	3	0
2015	3	3	0	3	3	0
2016	3	3	0	3	3	0

Në 000/lekë

Fondi i pagave, sigurimeve shoqërore & shëndetësore						
Vitet	Llog. 600 Fondi i Pagave			Llog. 601 Fondi i sigurimeve shoqërore & shëndetësore		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
2013	2,320	2,319	100	387	387	100
2014	2,373	2,368	100	397	395	100
2015	2,405	2,376	99	402	397	99
2016	2,405	1,641	68	402	270	67

Emergjencat Civile, Sektori PMNZSH 10 910 1

Ky sektor e zhvillon aktivitetit në bazë të ligji nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, ndryshuar me ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, në nivel qarku.

Sektori PMNZSH deri në vitin 2015 ka qenë me strukturë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë dhe nga 1 Janari 2016 kanë kaluar pranë Bashkive Lezhë, Kurbin e Mirditë sipas stacioneve përkatëse të PMNZSH.

Struktura dhe organika dhe niveli i pagës së këtij sektori bazohet në :

Pasqyra e numrit të punonjësve, fondit të pagave, sigurimeve shoqërore & shëndetësore Sektorit të PMNZSH paraqitet si më poshtë vijon:

Vitet	Numri i Punonjësve	Fondi i pagave, sigurimeve shoqërore & shëndetësore Në 000/lekë	
		Llog. 600 Fondi Pagave	Llog. 600 Fondi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

	Plan	Fakt	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
2013	47	47	31,650	31,570	100	5,235	5,224	100
2014	47	47	31,644	31,540	100	5,330	5,222	98
2015	48	48	32,200	32,121	100	5,500	5,339	97

Për periudhën viti 2013, 2014,2015 dhe 2016 nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturë, organikën dhe ligjshmërinë e rekrutimit në punë të punonjësve në institucion rezultoi:

1-Nga krahasimi i listë pagesave dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 139, datë 07.11.2008 rezultoi se është tejkuluar numri i punonjësve porsa i përket organikës së komisioneve vendore të shqyrtimit të titujve të pronësisë, e konkretisht janë miratuar 5 punonjës për këtë Drejtori dhe në fakt janë angazhuar dhe **dy punonjës të tjerë referuar VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitet e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”,kreu III, pika 4 ku thuhet: Prefekti i Qarkut , për raste të domosdoshme, mund të angazhojë pranë KV-re dhe punonjës të përkohshëm, për të kryer shërbime mbështetëse. Nga auditimi i veprimtarisë së këtij komisioni rezulton se ky komision pranë prefektit Lezhë ka marrë gjithsej 38 vendime , për 4 vitet objekt auditimi gjë që e bën të pamundur angazhimin e personave të tjerë në rolin mbështes për punë në këtë komision prej 5 punonjës. Marrja në punë e pa argumentuar dhe e pa justifikuar e 2 punonjësve për periudhën nga 16.03.2016 deri më 31.12.2016, bie ndesh me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 2, dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin si urdhërues për marrjen në punë të 2 punonjësve për periudhën nga 16.03.2016 deri më 31.12.2016 dhe shuma e pagesave të kryera për dy punonjësit është shumën prej 620,313 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare, pasi marrja në punë e tyre për një periudhë prej 10 muajsh për Komisionin e Verifikimit të Titujve të Pronësisë i përbërë prej 5 persona, është e pa argumentuar për domosdoshmërinë e nevojave për punë në këtë komision.**

Vlen të theksohet se dy punonjësit janë marrë në punë pranë Komisionit të Verifikimit të titujve të pronësisë vazhdojnë aktualisht të punësuar pranë këtij Komisioni.

Më hollësisht shuma dhe pagesat për dy punonjësit me emërim të përkohshëm në Komisionin Vendor të Titujve të Pronësisë për periudhën nga 16.03.2016 deri më 31.12.2016 paraqitet si më poshtë vijon:

Në lekë

Gj. M.							
Urdhër		Periudha sipas urdhrit	Muji	Paga Bruto	Sig. 11.2%	Tatim page	Paga neto
Nr	Date						
22	16.03.2016	116.03.2016-16.06.2016	Mars	22,429	2,512	0	19,917
=	=	=	Prill	47,100	5,275	2,223	39,602
=	=	=	Maj	47,100	5,275	2,223	39,602
50	16.06.2016	16.06.2016-16.07.2016	Qershor	47,100	5,275	2,223	39,602
55	16.07.2016	16.07.2016-	Korrik	47,100	5,275	2,223	39,602

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT
TE QARKUT LEZHE”**

		16.08.2016					
58	12.08.2016	16.08.2016- 15.09.2016	Gusht	47,100	5,275	2,223	39,602
61	14.09.2016	16.09.2016- 15.10.2016	Shtator	47,100	5,275	2,223	39,602
67	14.10.2016	16.10.2016- 15.11.2016	Tetor	47,100	5,275	2,223	39,602
70	15.11.2016	16.11.2016- 31.12.2016	Nëntor	47,100	5,275	2,223	39,602
=	=	=	Dhjetor	47,100	5,275	2,223	39,602
Shuma				446,329	49,987	20,007	376,335

Në lekë

Urdhër		M. S.					
Nr.	Datë						
52	01.07.2016	01.07.2016- 30.09.2016	Korrik	48,500	5,432	2,405	40,663
=	=	=	Gusht	48,500	5,432	2,405	40,663
63	29.09.2016	01.10.2016- 31.12.2016	Shtator	48,500	5,432	2,405	40,663
=	=	=	Tetor	48,500	5,432	2,405	40,663
=	=	=	Nentor	48,500	5,432	2,405	40,663
=	=	=	Dhjetor	48,500	5,432	2,405	40,663
Shuma				291,000	32,592	14,430	243,978

2- Janë konstatuar shkelje në lidhje me rekrutimi në punonjësve në punë pa zhvilluar procesin e rregullt ligjor të konkurrimit, e konkretisht është emëruar me aktin e emërimit nr. 3, datë 30.06.2014, nga ish Prefekti N. D. deri më 01.09.2016 Justina Përleka me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik, datë e cila është bërë sipas Urdhrit nr. 11, datë 15.02.2016, të Prefektit aktual E. N. lirimi nga detyra, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 22,23,24 dhe ngarkon me përgjegjësi ish Prefektin N. D.

3 - Për sa i përket likuidimit të vendimeve gjyqësore nga auditimi rezultuan se janë kryer vetëm bazuar në vendimet e gjykatës së apelit (të cilat janë të formë së prerë dhe të ekzekutueshme), pa i ankimuar ë gjykatën e lartë. Kryesisht ekzekutimi i vendimeve gjyqësore janë për ish punonjës të larguar nga viti 2010 për 12 ish punonjës në shumën prej 10,737,386 lekë, për vitin 2014 për dy punonjës në shumën prej 1,744,039 lekë dhe për vitin 2015 për 3 ish punonjës në shumën prej 2,108,596 lekë dhe për vitin 2016 për dy ish punonjës në shumën prej 955,000 lekë. Për vendimet gjyqësore të likuiduara deri në fund të vitit 2016 nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative para se të likuidoheshin referuar pikës 62 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, dhe pika 38 të UMB nr. 459, datë 16.08.2013. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër ngarkojnë me përgjegjësi Altin Jaku me detyrë ish Sekretarin e Përgjithshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

5. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, në përputhje me disiplinën financiare.

5.1. Respektim i rregullave në përdorim, dokumentim, regjistrim në kontabilitet të fondeve.

Për dokumentimin dhe regjistrimin në kontabilitet të aktiveve janë mbajtur:

a. dokumentacion autorizues (Urdhërat për krijimin e komisioneve, urdhërat për prokurimet, kontratat, etj);

b. dokumentacion vërtetues (fletë hyrje/dalje, fatura, situacione, urdhër pagesa, procesverbale, etj);

c. dokumenta të kontabilitetit (libri i madh, ditarë analitike, kartelat e aktiveve, etj).

Grupi i auditimit *verifikoi* regjistrimet në kontabilitet dhe *rezultoi se* regjistrimet justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare, të cilat sigurojnë besueshmërinë e regjistrimeve të kryera. Në kontabilitet mbahet regjistrimi i fondeve në llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar”. Ajo preket për fondet që kalojnë në bankë por jo për fondet që i vihen në dispozicion institucionit në degën e thesarit. Për dokumentimin e blerjeve të mallrave pritet fletë hyrje sipas faturës së furnitorit. Nga kontrolli i ditarit të bankës rezulton se mbahet kredia e llogarisë 520, për shpenzimet e kryera.

5.2. Auditimi i disponibiliteteve (operacionet e bankës dhe arkës).

Veprimet me bankë.

Ditari i bankës mbahet në mënyrë elektronike rregullisht çdo muaj, sipas ligjin Nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr.9477, datë 09.02.2006, dhe me ligjin nr.10110, datë 02.04.2009, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore e lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”.

Veprimet janë kryer nëpërmjet degës së thesarit, likuiduar me urdhër shpenzim, shoqëruar me dokumentet justifikuese ku përcaktohet dhe qëllimi i shpenzimit. Likuidimet e kryera nëpërmjet bankës për vitet 2013- 2016 janë kryer në lekë. Mbështetur në dokumentacionin e kaluar nëpërmjet Degës së Thesarit Lezhë mbi shpenzimet e kryera nga institucioni i Prefektit rezulton se janë kryer shpenzime në total sipas viteve:

Nr	Periudha	Urdhërshpenzimet		vlera
		Numri rendor	totali	
1	01.01.2013-31.12.2013	1-227	227	76,648,264
2	01.01.2014-31.12.2014	1-279	279	91,107,411
3	01.01.2015-31.12.2015	1-274	274	81,866,154
4	01.01.2016-31.12.2016	1-254	254	33,859,355
5	Totali		1,034	283,481,184



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Nga totali i shpenzimeve të kryera nëpërmes degës së thesarit Lezhë, janë kryer shpenzime për blerje dhe shërbime kryesisht me procedurë me vlerë të vogël.

Për sa i përket veprimeve me arkë për periudhën objekt auditimi në institucion, rezultojnë se nuk janë kryer.

5.3. Mbi zbatimin e procedurave të prokurimeve publike dhe kontratave për blerje dhe shërbime me vlera të vogla dhe pagesat e kryera, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

Bazuar në kërkesat e përcaktuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr. 2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 5 datë 16.07.2013 dhe nr. 1, datë 28.02.2014, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar, për periudhën e audituar, me miratimin e buxhetit, sipas nevojave të institucionit të Prefekturës, janë parashikuar fonde për blerje mallrash e kryerje shërbimesh në vlera të vogla, me procedurën e prokurimit elektronik, duke përcaktuar sasinë, llojet dhe zërat e punimeve apo shërbimeve që do të kryhen, për të cilat është hartuar regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike.

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të realizuara për blerjen e disa lloj mallrash e shërbimesh me vlera të vogla, si blerje karburanti, pjesë këmbimi, rikonstruksione të ndryshme etj. rezulton se nuk janë patur parasysh kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, UAPP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr. 3 datë 27.01.2015, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 1 datë 21.04.2016.

Për sa i përket procedurave dhe dokumentimit të blerjeve për periudhën e audituar është ndjekur kjo praktikë dokumentare:

a -Në fillim të vitit kalendarik, Titullari i institucionit, me urdhër të veçantë ka ngritur komisionin e blerjeve në vlera të vogla, i përbërë prej 3 anëtarë dhe konkretisht: me urdhrin nr.1 datë 03.01.2013 për vitin 2013, nr. 35 datë 03.03.2014 për vitin 2014 dhe nr. 02 datë 29.01.2015 për vitin 2015, nr.9, datë 10.02.2016 dhe është pajisur me llogari përdoruesi personi i autorizuar i sistemit elektronik.

b -Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka përcaktuar fondin limit duke bërë më parë hartimin e kërkesave vjetore për mallra apo shërbime të ndryshme, testimin e tregut dhe ka hartuar urdhër prokurimin sipas formatit standart të përcaktuar në Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i cili është miratuar nga Nëpunësi Autorizues. Ftesa për ofertë është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla (KPVV), duke ftuar të paktën tre ofertues. Ofertuesit kanë paraqitur ofertën e tyre brenda 24 orëve nga shpallja e saj. KPVV ka bërë vlerësimet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), sipas çmimit më të ulët dhe kanë kryer blerjen e mallit. Hapat e procesit janë formalizuar në procesverbalin e mbajtur nga KPVV, si dhe njoftimi i fituesit është gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE). Për të gjitha rastet e blerjeve, janë mbajtur procesverbale, të cilët janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe në përfundim është hartuar raporti i blerjes.

c -Mbi bazën e këtij dokumentacioni dhe faturës së shitësit është bërë hyrje e mallit në magazinë dhe kontabilizimi i veprimeve në librin e kontabilitetit.

d-Për procedurat e blerjeve me vlera të vogla në mënyrë elektronike në disa raste nuk ka urdhër për ngritje të komisionit dhe procesverbal për marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.

Për periudhën objekt auditimi në institucion kryesisht shpenzimet për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh janë kryer me “procedurë blerje e vogël”, të cilat për vitin 2013 janë në shumën prej 1,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

922,819 lekë , për vitin 2014 në shumën prej 4,025,283 lekë dhe për vitin 2016 në shumën prej 1,843,533 lekë.

Prokurimi i fondeve në raste dhe në vlerë për periudhën 2013-2014-2015-2016 sipas llojit të shpenzimit paraqitet si më poshtë vijon:

N r.	Emertimi	Viti 2013		Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		ra st e	le ke	ra st e	le ke	ra st e	le ke	ra st e	le ke
1	Kancelari	7	205,114	5	273,325	3	242,488	3	255,639
2	Mat. pastrimi, gaz ngrohje	5	122,742	3	138,170	3	115,120	2	74,718
3	Mater.(boje prin.fot.let. Fax.	6	243,140	5	273,695	3	260,000	3	318,440
4	Bler. Dok. (fh,fd, ditar, etj.)	3	5,588	6	43,200	3	20,000	2	18,000
5	Mallra te tjera pergjithshme	6	98,992	8	346,738	3	152,068	3	169,600
6	Paisje per perdorim policor	0	0	1	450,000	1	310,800	0	0
7	Mallra dhe sherbime te tjera speciale	0	0	1	388,800	0	0	0	0
8	Sher.sig.e ruajtj.(roje privat)	1	348,000	1	57,600	1	249,480	1	292,296
9	Sherbime pastrim zyra Kurbin/ Mirdite	0	0	1	113,880	1	113,976	1	98,388
10	Karburant, D1, vaj 13-5-16	1	3,212,678	1	4,055,430	1	4,773,815	1	963,753
11	Pjese kembimi e nderrimi	6	431,596	9	800,560	8	908,864	2	228,800
12	Kosto e sig. te automjeteve	1	89,097	1	699,561	1	378,409	1	44,172
13	Shp.tjera transporti.(larje makine)	1	20,000	1	84,616	1	66,000	1	72,000
14	Miremb. objekteve ndertimore	0	0	1	367,212	0	0	0	0
15	Mirembajtje e paisje zyrave	4	79,890	3	39,440	3	98,000	2	99,480
16	Mirembajtje mjete transporti	6	131,780	9	471,800	8	390,200	3	172,000
17	Shp. Per qeramarrje	1	146,880	1	146,880	1	719,878	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

1		0	0	2	531,959	0	0	0	0
8	Blerje paisje dhe orendi zyre								
	Shuma totale	47	1,922,819	58	5,022,956	40	4,025,283	24	1,843,533

Për periudhën objekt auditimi komisioni i blerjeve të vogla është ngritur për vitin 2013 me Urdhrin nr. 1, datë 03.01.2013, për vitin 2014 me Urdhrin nr. 35, datë 03.03.2014, me Urdhrin nr. 54, datë 01.07.2014, dhe me urdhrin nr. 2, datë 29.01.2015 i përbërë nga E. Z., J. P. dhe N. M, i ndryshuar me urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015 i përbërë nga J. P. Kryetare, A. P. dhe B. V. Për vitin 2016, është ngritur me urdhrin nr. 9, datë 10.02.2016 i përbërë nga J. P., E. P. dhe E. Z., ndryshuar me urdhrin nr. 66, datë 14.10.2016 i përbërë nga E. Z. kryetare, I. N., V. L.

- Auditimi i veprimeve me bankën u krye me zgjedhje për viti 2013, 2014, 2015 dhe 2016 u krye për të gjithë periudhën.

Për vitin 2013 dhe 2014 u auditua tremujori i parë, dhe tre mujori i fundit nga ku rezultoi se në përgjithësi janë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, e konkretisht të gjitha veprimet nëpërmjet bankës janë nënshkruar nga nëpunësi zbatues, të autorizuar nga Titullari i institucionit dhe janë të konfirmuara nga dega e thesarit të rrethit. Janë përgatitur rregullisht situacionet mujore dhe periodike të shpenzimeve të cilat janë të konfirmuara dhe nga thesarit.

- Nga auditimi i veprimeve me bankën për vitin 2014 dhe 2015.

I-Në institucion janë kryer pagesa për vendime gjyqësore për vitin 2014 në shumën prej 10,693,077 lekë për 14 ish punonjës dhe për vitin 2015 në shumën prej 1,153,596 lekë për 3 ish punonjës në bazë të vendimeve të gjykatës së apelit (e cila ka marrë formë të prerë), por pa kaluar në të gjitha shkallët gjyqësore dhe pa nxjerrë përgjegjësitë administrative para se të kryheshin pagesat, veprime që bien ndesh me pikën 62 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave me nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi ish prefektin N. D. dhe ish Sekretarin e Përgjithshëm A. J.

II- Gjithashtu është konstatuar se për vitin 2014 janë kryer pagesa për shpenzime për furnizim me ujë në shumën prej 151,212 lekë, për vitin 2015 në shumën prej 129,720 lekë dhe për vitin 2016 në shumën prej 115,920 lekë pa lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime sha Lezhë por bazuar në fatura afrofe të lëshuara prej tyre.

III- Janë kryer pagesa në shumën prej 212,400 lekë për riparime dhe shërbime automjeti e kryer me procedurë blerje e vogël, **duke i trajtuar si raste emergjente**, veprime që bien ndesh me Udhëzimin e AP nr. 3, datë 27.01.2014 “ Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël” pika 7, pasi kanë kaluar vlerën prej 100, 000 lekë. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi J. P., E. Z., E. P., I. N. dhe V. L. me detyrë komisioni i blerjeve të vogla.

a. Me urdhërpagesën nr. 136, datë 21.07.2016 është kryer pagesë për shërbim dhe riparim automjetit në shumën prej 96,000 lekë **subjektit Serdado shpk** sipas faturës nr. 451, datë 14.07.2016. Ky riparim dhe shërbim është kryer për automjetin tip ëolsvagen passsat me targë Le 6155 A referuar procesverbalit të datës 14.07.2016 të mbajtur nga komisioni i blerjeve të vogla i përbërë nga J. P., E. Z. dhe E. P. për aprovimin e kryerjes së këtij riparimi bazuar në procesverbalin e datës 14.07.2016 i mbajtur nga shoferi i mjetit dhe Prefektit E. N. mbi defektin e makinës ndodhur në Ishull Lezhë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

b. Me urdhërpagesën nr. 199, datë 26.10.2016 është kryer pagesë në shumën prej 116,400 lekë **për subjektin Serdado shpk** për shërbim dhe riparim automjeti tip ëolsvagen passsat me targe Le 6155 A, sipas faturës nr. 554, datë 21.10.2016. Bashkëngjitur kësaj urdhërpagese gjendet Urdhër të Prefektit E. N. për ndryshim komisioni të prokurimit për blerje të vogla me nr. 66, datë 14.10.2016 i përbërë nga E. Z. kryetare, I. N., anëtar dhe V. L. anëtare. Gjithashtu bashkëngjitur kësaj urdhërpagese është dhe procesverbali i datës 24.10.2016 i mbajtur nga komisioni i blerjeve të vogla i cili ka përcaktuar si rast të emergjencës dhe e ka miratuar rastin e riparimit të makinës bazuar në procesverbalin e mbajtur nga shoferi i automjetit K. Ç. dhe Prefekti E. N. i datës 21.10.2016 mbi defektin e makinës e ndodhur në Ishull Lezhë.

Vlen të theksohet se për këtë mjet me urdhërpagesën nr. 115, datë 15.06.2016 është kryer pagesë për mirëmbajtje dhe vendosje pjesë këmbimi për automjetin tip volsvagen passsat në shumën prej 200,400 lekë, subjektit “Kaziu 2013” shpk sipas faturës nr. 171, datë 10.06.2016.

III. Janë kryer pagesë për shpenzime për lavash mjeti i cili është jashtë funksionimit dhe pa **targa** sipas urdhrit të prokurimit nr. 5, datë 10.05.2016 “Për prokurimin me vlera të vogla”, **në shumën prej 35,200 lekë e cila përbën dëm ekonomik** pasi bie ndesh me ligjin nr. 10 296 , datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2013 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 10 dhe ngarkon me përgjegjësi ish shefen e financës S. F. deri më 18.07.2016, dhe shefin aktual të financës dhe shërbimeve S. K., i cili **ka kërkuar në bazë të shkresës së datës 09.05.2016**, drejtuar komisionit të blerjeve të vogla **larjen e dy automjeteve** të institucionit, njëri prej të cilave rezulton jashtë funksionimit, e cila nuk ka leje qarkullimi dhe targa E konkretisht:

- Me urdhërpagesën nr. 114, datë 15.06.2016 në shumën prej 4 800 lekë janë paguar për shpenzime për larje automjetesh (lavash makine BMË larje 8 x 400 lekë në shumën prej 3200 lekë) dhe mjeti Pasat Le G 155 A larje 4 x 460 lekë në shumën 1,600 lekë) sipas faturës së thjeshtë tatimore me nr. 6, datë 07.06.2016 dhe kontratës me nr. 616 datë 16.05.2016 të lidhur ndërmjet subjektit privat E. C. dhe Prefektit E. N. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate duhen të kryhet shërbimi lavash për dy automjete BMV 4 larje javore (e cila rezulton të jetë pa targa dhe jashtë funksionimit) dhe mjeti Volsëagen Passat 2 larje javore. Kjo urdhërpagesë e firmosur nga urdhëruesi titullari dhe nëpunësi zbatues S. F. nuk ka të shoqëruar dokument vërtetuese të firmosura nga shoferi për kryerjen e këtij shërbim për periudhën nga 16.05.2016 deri 31.05.2016.

- Me urdhërpagesën nr. 129 datë 18.07.2016 në shumën prej 9 600 lekë është kryer pagesë të firmosur nga titullari si urdhërues fondesh dhe nga S. K. në cilësinë e nëpunësit zbatues për shpenzime për larje automjetesh (lavash makine BMV larje 16 x 400 lekë në shumën prej 6,400 lekë cila është jashtë funksionimit dhe pa targa e cila e bën të pamundur lëvizjen e tij dhe për mjetin Ëolsëagen Passat Le G 155 A larje 8 x 400 lekë në shumën prej 3,200 lekë), sipas faturës së thjeshtë tatimore me nr. 12 datë 05.07.2016 sipas kontratës me nr. 616 datë 16.05.2016, për muajin Qershor 2016 dhe dokumentit të firmosur nga shoferi për muajin Qershor për dy automjetet nga K. C.

Vlen të theksohet se shoferi K. Ç. është emëruar shofer në institucion me Urdhër nr. 13, datë 15.02.2016, dhe ka kryer detyrën e shoferit pa pasur mjetin në ngarkim me kartelë pranë institucionit deri më 30.11.2016 sipas Urdhrit të liritimit nga detyra me nr. 71, datë 30.11.2016 të E. N.

Sipas të dhënave të kontabilitetit referuar pasqyrave financiare të vitit 2015 dhe 2016 në institucion gjenden 2 mjete të cilat janë Ëolsëagen Passat në vlerë prej 2,975,000 lekë dhe automjeti BMË pa vlerë në kontabilitet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

-Referuar inventarit të mjeteve të institucionit të Prefektit të datës 04.12.2015 këto dy mjete janë aktualisht në ngarkim referuar inventarin të datës 04.12.2015 të ish shoferit të institucionit G. M. larguar nga institucioni me Urdhrin nr. 11, datë 15.02.2016 të Prefektit dhe të ish shoferit L. Ll. i larguar me Urdhrin nr. 12, datë 15.02.2016 të Prefektit, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi ish shefen e financës S. F. dhe shefin aktual të financës dhe të shërbimeve S. K. në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2013 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 2,7,10,12, dhe 13.

- Me urdhërpagesën nr. 168, datë 14.09.2016 në shumën prej 19,200 lekë është kryer pagesë për shpenzime për larje automjesh (lavash makine BMË larje 16 x 400 lekë në shumën 6,400 lekë) dhe mjeti Passat Le G 155 A larje 8 x 400 lekë në shumën 3,200 lekë) sipas faturës së thjeshtë tatimore nr. 27, datë 26.08.2016 për muajin Korrik 2016,dhe sipas faturës nr. 34, datë 06.09.2016 për muajin Gusht 2016 (për mjetin BMË 4 larje x 4 00 lekë në shumën 6,400 lekë dhe për mjetin Ëolsvagen passat 8 larje në vlerë 3,200 lekë) sipas kontratës me nr. 616 datë 16.05.2016. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate duhet të kryhet shërbimi lavash për dy automjete BMV me 4 larje javore (mjet i cili është jashtë funksionimit dhe pa targa e cila e bën të pamundur lëvizjen) dhe Volsëagen Passat. Bashkëngjitur kësaj urdhërpagese janë dhe dy dokumente firmosura nga shoferi K. Ç. për kryerjen e këtij shërbimi për muajin Korrik dhe Gusht për të dy makinat.

- Me urdhërpagesën nr. 198, datë 26.10.2016 në shumën prej 9,600 lekë është paguar për shpenzime për larje automjesh (lavash makine BMË larje 16 x 400 lekë në shumën 6,400 lekë) dhe për mjetin Ëolsvagen Pasat Le G 155 A larje 8 x 400 lekë në shumën 3,200 lekë) sipas faturës së thjeshtë tatimore nr. 46, datë 18.10.2016 për muajin Shtator 2016, sipas faturës nr. 46, datë 18.10.2016 për muajin Shtator, bashkëngjitur dhe dokumenti i firmosur nga shoferi për kryerjen e këtij shërbimi për muajin Shtator për të dy makinat bazuar në kontratën me nr. 616 datë 16.05.2016. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate duhen të kryhet shërbimi lavash për dy automjete BMV 4 larje javore (e cila është jashtë funksionimit) dhe mjeti Volsëagen Passat.

-Me urdhërpagesën nr. 217, datë 24.11.2016 në shumën prej 9,600 lekë janë kryer pagesa për shpenzime për larje automjesh (lavash makine BMË larje 16 x 400 lekë në shumën 6,400 lekë) dhe për mjetin Ëolsvagen Passat Le G 155 A larje 8 x 400 lekë në shumën 3,200 lekë) sipas faturës së thjeshtë tatimore nr. 75, datë 16.11.2016 për muajin Tetor 2016, sipas kontratës me nr. 616 date 16.05.2016. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate duhen të kryhet shërbimi lavash për dy automjete BMV 4 larje javore (e cila rezulton pa targë dhe jashtë funksionimit) dhe për Volsëagen Passat. Bashkëngjitur këtij urdhër shpenzimi është dhe dokumenti të firmosura nga shoferi për kryerjen e këtij shërbim për muajin Tetor 2016 për dy mjete.

- Me urdhërpagesën nr. 249, datë 27.12.2016 në shumën prej 19,200 lekë janë kryer pagesa për shpenzime për larje dy automjete (lavash automjeti BMË (jashtë funksionit 16 larje në vlerë 6,400 lekë dhe lavash automjeti Ëolsvagen Passat Le G 155 A 8 larje në vlerë 3,200 lekë,sipas faturave të thjeshta tatimore me nr. 61, datë 05.12.2016 për muajin Nëntor dhe me nr. 65, datë 21.12.2016 për muajin Dhjetor të subjektit fizik E. C. Bashkëngjitur këtyre faturave janë dhe dy dokumente të firmosura nga shoferi K. Ç. ka janë përcaktuar datat për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2016 kur është kryer lavash për dy automjete.

6. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për periudhën objekt auditimi rezulton se për vitin 2013-2014 nuk janë evidentuar procedura prokurimi, kryesisht shpenzimet për blerje mallrash dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

shërbimesh janë kryer me procedurë “Blerje me vlera të vogla”, zëri karburant dhe vaj mjetesh si për Administratën e Prefektit dhe për Sektorin e PMNZSH është prokuruar nga Drejtoria e Prokurimeve në Ministrinë e Brendshme. Për vitin 2015 dhe vitin 2016 janë evidentuar 2 procedura prokurimi të llojit “Kërkesë për propozim” dhe “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” nga auditimi i të cilave u evidentuan gjetje në procedura si më poshtë:

1. Mbi auditimin e realizimit të procedurës së prokurimit publik, procedurë “Kërkesë për propozim” me objekt ***Rikonstruksioni i zyrave të institucionit të Prefektit Lezhë*** për vitin 2015, me këto të dhëna:

Të dhënat për tenderin	Njësia e prokurimit	Komisioni i vlerësimit të ofertave
1. Urdhër Prokurimi nr .1,datë 29.01.2015 2. Fondi limit 1,589,167 lekë(pa tvsh). 3. Pr.Prok.“ Kërkesë për propozim“. 4. Data e zhvillimit tenderi 02.03.2015. 5.Firma fituese ”Kthella” sh.p.k. 6. Data e lidhjes kontratës 30.03.2015. 7.Vlera kontratës 1,846500 lekë(me tvsh).	Urdhër nr.01,datë 29.01.2015 1.J. P.,juriste 2.E. Z.,ekonomiste, 3.N. M.,ing ndertimi	UP.nr.3,datë 29.01.2015 1.A. J.,kryetar 2 B. Z.,anetar 3.N. Z.,anetar 4.B. V.,anetar 5.N. G., anetar

Kërkesa dhe fondit limit dhe procedura e prokurimit janë pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2015. Në urdhrin e prokurimit nr. 1 datë 29.01.2015.2015 thuhet: “Të kryhet prokurimi i fondit 1,907,000 lekë me tvsh me objekt *”Për rikonstruksionin e zyrave të Prefekturës”* për vitin 2015,me procedurë prokurimi “Kërkesë për propozim”, në rrugë elektronike.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatuan këto shkelje ligjore:

A- Llogaritja e fondit limit:

Në proces verbalin e hartimit të dokumenteve të tenderit (DST) të autoritetit kontraktor Institucioni i prefektit (nr. 1, datë 29.01.2015) rezulton se nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së kërkesave për kualifikim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61 ”Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2 dhe me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për prokurimin publik”, neni 46 ”Kualifikimi i ofertuesve” pika 3.

Në dosjen e tenderit nuk ka asnjë dokument si procesverbal për mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit. Këto veprime bien ndesh me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 12, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 9, Urdhrin nr. 33, datë 11.07.2013 të Ministrisë së Financave “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” dhe ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga J. P., E. Z., N. M.



B-Zhvillimi i procedurës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konkretisht raportit përmbledhës përfundimtar të KVO, referuar procesverbalit të datës 06.03.2015,rezulton se **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** ka kryer vlerësimin përfundimtar të ofertave dhënë nga operatorët si vijon:

1. C. M. sh.p.k me vlerë 1,197,850 lekë pa tvsh.
2. A. & A. shpk nuk ka dorëzuar ofertën ekonomike.
3. M. shpk me vlerë 1,566,237 lekë, pa tvsh.
4. B. sh.p.k me vlerë 40,809,478 lekë pa tvsh.
5. R. 94 shpk me vlerë 1,359,298 lekë pa tvsh.
6. U. N. shpk, nuk ka dorëzuar ofertën ekonomike.

Nga **Komisioni i Vlerësimit të Ofertave** janë s’kualifikuar operatorët “C. M. shpk, A. & A. shpk, R. 94 shpk, U. N. shpk dhe është shpallur fitues operatori ekonomik “K.” sh.p.k me vlerë 1,538,750 lekë pa tvsh me *diferencë nga fondi limit 50,417* lekë. Arsyet e skualifikimit referuar dokumentacionit të operatorëve ekonomikë janë:

- Subjektit“ A dhe A” shpk me ofertë 1,478,484 lekë pa tvsh nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik dhe është s’kualifikuar, gjithashtu KVO ka argumentuar se dokumentacioni i paraqitur nga OE “C M” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe për këtë arsye oferta është s’kualifikuar pasi mungon vërtetimi për pagimin e energjisë elektrike për tre muajt para hapjes së tenderit, dhe OE “R” shpk është s’kualifikuar pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e pagesës së energjisë elektrike për tre muajt e fundit para datës së hapjes së tenderit dhe gjithashtu drejtuesi teknik nuk gjendet në listëpagesat e punonjësve të deklaruara në degën e tatim taksave.

Arsyet e kualifikimit të OE “K” shpk, dhe “M” shpk është se dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe përputhet plotësisht me kërkesat e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. KVO ka shpallur fitues OE “K” shpk me vlerë 1,538,750 lekë (pa tvsh). Nga auditimi rezulton se nuk kanë paraqitur ankesa asnjë nga OE në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe klasifikimin përfundimtar.

Lidhur me procedurën e mbikëqyrjes dhe realizimit të kontratës :

Mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori është përcaktuar nga institucioni me procedurës së blerjeve të vogla nëpërmjet sistemit elektronik.

C- Financimi i kontratës së, datës 30.03.2015 është bërë sipas situacioneve të punimeve me urdhërpagesën nr. 87, datë 21.05.2015 në shumën prej 1,300,000 dhe me urdhërpagesën nr. 87/1 datë 22.05.2013 në shumën prej 546,000 lekë.

D- Zbatimi i kontratës së punimeve me objekt”*Rikostruksioni i zyrave të institucionit të Prefektit Lezhë*”

Nga auditimi i ushtruar në lidhje me dokumentacionin teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit në objektin “**Rikonstruksion i zyrave te Institucionit te Prefektit Lezhe**”, Lezhë rezultoi:

Projekti.

Projekti për këtë investim është hartuar nga ing. N. M. dhe parashikon punime hidroizolim tarrace, suvatime, patinime muri, lyerje me boje hidroplastiko, shtresë me pllaka gress, punime duralumini, instalime elektrike dhe hidraulike etj. Punimet këto që do të kryhen në Institucionit të Prefektit Lezhë dhe Nën/Prefektura Laç. Vlera e parashikuar e investimit, e përdorur edhe në përcaktimin e fondit limit është **1 907 000 lekë me tvsh**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Kontrata.

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE “K” sh.p.k . Punimet në objekt janë kryer në bazë të kontratës për punë publike me nr. 590, datë 30.03.2015 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Prefekti Qarkut Lezhë dhe OE me vlerë të kontratës **1 846 500 lekë me tvsh**, me afat zbatimi kontrate 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës së lidhur me OE është **60,500 lekë pa tvsh ose 3,1 % më pak se fondi limit**.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është caktuar N. M, me nr. licence MK 0992/2 datë 05.12.2011 me të cilin është lidhur kontrata me nr. 651 datë 30.03.2015 me vlerë 1,800 lekë.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është caktuar ing. Z. B. me nr. Lic. MK .0220/1 ,datë 01.04.2013 me të cilin është lidhur aktmarrëveshja me nr. 863, datë 27.04.2015 me vlerë 0 lekë.

Gjetje nga auditimi:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se caktimi i kolaudatorit të punimeve nuk është bërë me procedurë ligjore sipas LPP pra me përzgjedhje me prokurim por vetëm me marrëveshje të ish-Titullarit.

Zbatimi i punimeve.

Nga auditimit rezultoi se pjesë e dosjes teknike ishte dokumentacioni si më poshtë:

31.03.2015 - Akti i dorëzimit të sheshit;

01.04.2015 - Njoftim nga mbikëqyrësi për fillimin e punimeve;

01.04.2015 - Njoftim nga sipërmarrësi për fillimin e punimeve;

01.04.2015 - Akti i Piketimit;

08.04.2015 - Procesverbal i ndryshimit të volumeve;

01.04.2015 - 23.04.2015 Ditari i punimeve;

23.04.2015 - Njoftim nga sipërmarrësi për përfundimin e punimeve;

Deklarata teknike e sipërmarrësit të punimeve;

23.04.2015- Proces-Verbal mbi përfundimin e punimeve .

27.04.2015 - Relacioni i mbikëqyrësit të punimeve;

29.04.2015 - Akti i kolaudimit;

19.05.2015 - Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve.

Nga auditimi rezulton se në dosjen teknike mungojnë dokumentacioni si më poshtë:

-Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura;

-Aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve;

Nga krahasimi i volumeve të situacioneve dhe punimeve të kryera në fakt u konstatuan **diferenca në volume pune të pakryera me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 38,317.5 lekë pa tvsh**. Konkretisht:

Tabela 1

Nr.	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca ne +	
5	Hidroizolim tarrace 1 dore k/k	M2	1,170	432	432	399,25	32,75	38317,5
	Total							38317,5



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Të argumentuara këto si më poshtë:

Zëri nr. 5: Hidroizolim tarrace 1 dore k/katroma

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin prej 432 m² Hidroizolim tarrace 1 dore k/katroma. Libri masave pasqyron në mënyrë analitike volumin prej 432 m² Hidroizolim tarrace 1 dore k/katroma. Në fakt, gjatë verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit rezultoi se ngritja në mur e k/katramas është bërë në lartësinë 0,3 m dhe jo në lartësinë 0.8 m sipas librezës së masave. Duke bërë korrigjimet rezulton se gjatësia e murit është (65,25 m x 0,3 m = 19.57 m², sipas librezës së masave është 65,25 m x 0,8 m = 52,2 m²). Si rrjedhojë, janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 32,75 m² hidroizolim tarrace me 1 dorë k/katroma.

Si përfundim, janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve vlera **38,317.5 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e punimeve të situacionuara e të likuiduara por të pakryera në fakt.

Për sa më sipër, **ngarkohen me përgjegjësi** si më poshtë:

- **Mbikëqyrësi i punimeve**, Ing. N. M:

1. Nuk është zbatuar ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

2. Nuk është zbatuar kontrata e shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve, datë 14.04.2015, konkretisht neni 3, 4 dhe neni 7;

- **Kolaudatori i punimeve**, Ing. Z. B. pasi:

1. Nuk është zbatuar ligji nr., 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, dhe konkretisht neni 12.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

2. Nuk është zbatuar kontrata e shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve, datë 14.04.2015, konkretisht neni 3;

- **Nga mbikëqyrësi i punimeve** Ing. N. M. dhe **nga kolaudatori i punimeve** Ing. Z. B., nuk janë marrë masa për zbatimin e UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, pika 15, germa ç.

- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, Ing. N. M. dhe **nga kolaudatori i punimeve**, Ing. Z. B. nuk është zbatuar UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm në dosjen teknike.

Nga krahasimi i volumeve të situacioneve dhe punimeve të kryera në fakt u konstatuan **diferenca në volume pune të pakryera me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 38,317 lekë pa tvsh.**

2. Mbi auditimin e realizimit të procedurës së prokurimit publik, procedurë “Negocim pa shpallje të njoftimit të kontratës” me objekt “ Blerje karburanti ” për vitin 2015, me këto të dhëna:

Të dhënat për tenderin	Njësia e prokurimit	Komisioni i vlerësimit të ofertave
1.Urdhër Prokurimi nr.18 datë 03.12.2015	Urdhër nr.18,datë 03.12.2015 1.J. P.,juriste	UP.nr.39,datë 03.12.2015



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

2. Fondi limit 416,666 lekë (pa tvsh). 3. Pr.Prok.“Negocim pa shpallje“. 4. Data e zhvillimit tenderi 04.12.2015. 5.Firma fituese ”Kastrati” sh.p.k. 6. Data e lidhjes kontratës 04.12.2015. 7.Vlera kontratës 499,999 lekë (me tvsh).	2.B. V.,ekonomiste, 3.A. P.,oficer	1.I. N.,kryetar 2.A. P.,anetar 3.N. Z.,anetar
---	---------------------------------------	---

A. Llogaritj e fondit limit

Nga auditimi rezulton se në dosjen e tenderit nuk gjenden dokumente për përlllogaritjen e fondit limit për karburantin pasi nuk gjendet asnjë procesverbal i mbajtur nga njësia e prokurimit për këtë qëllim, veprim i cili bie ndesh me ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 12, me VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Urdhrin nr. 33, datë 11.07.2013 të Ministrisë së Financave “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga J. P., B. V., A. P.

B. Përzgjedhja e procedurës së prokurimit.

Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, në institucion referuar urdhrin të prokurimit nr. 18, datë 03.12.2015 “Për blerje karburanti” është kryer bazuar se Sektori i PMNZSH ndodhet para një situatë emergjente për karburant, si pasojë e zjarreve të shumta gjatë sezonit turistik në verë 2015 dhe si pasojë është konsumuar sasia e karburantit. Për të përballuar situatat e të ftohtit në mungesë të karburantit është përzgjedhur kjo procedurë prokurimi. Bashkëngjitur këtij urdhër prokurimit janë:

-Shkresa e datës 16.11.2015 të Sektorit të **PMNZSH** me objekt “Kërkesë emergjente për furnizim me karburant”, të A. P. drejtuar A. J. ish Sekretar i Përgjithshëm dhe për dijeni Sektorit të Shërbimeve të Brendshme N. Z. Sipas kësaj shkrese janë përcaktuar sasi të 3, 000 litra të karburantit për nevojat emergjente të sektorit të PMNZSH.

-Kërkesa e ish shefit të shërbimeve të brendshme N. Z. e datës 02.12.2015 drejtuar njësisë së prokurimit e ngritur për zbatimin e kësaj procedure prokurimi e përbërë nga J. P., B. V. dhe A. P. ngritur me urdhrin nr. 18, datë 03.12.2015 të ish-Sekretarit të Përgjithshëm Altin Jaku, ku cilësohet se në bazë të kërkesës së Sektorit të PMNZSH, njësia e prokurimit që të kryhet procedura e blerjes së karburantit (naftë) në sasi prej 3,000 litra me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake” për arsye emergjente.

Nga auditimi rezulton se argumentimi i sasisë prej 3,000 litra për nevojat e sektorit të PMNZSH nuk është e shoqëruar me dokumente të magazinës ku të përcaktohej dhe gjendja e karburantit më datën 16.11.2015 dhe më pas nevojat për karburant në këtë sektor të detajuar sipas automjeteve dhe vendndodhjes së tyre. Gjithashtu theksojmë se situata emergjente e zjarreve ka qenë në periudhën e verës dhe për nevojat për karburant procedurat e prokurimit duheshin të kishin filluar dhe jo të kryheshin më 16.11.2015 kur është bërë kërkesa për nevojat karburant, pra pas rreth 4 muaj. Me shkresë nr. 1528, datë 30.09.2015 të ish Sekretarit të Përgjithshëm të A. J. drejtuar Sekretarit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme është kërkuar shtesë kontrate (në masën 20%) për karburant për gatishmëri dhe nevoja emergjente të sektorit të PMNZSH pasi numri i madh i zjarreve të rëna në qarkun Lezhë dhe marrja pjesë në shuarjen e zjarreve në Prefekturën Shkodër ka bërë që kontrata e datës 04.03.2015 me afat deri më 31.12.2015. Pra rezulton se me urdhërpagesën nr. 206, datë 22.10.2015 me fondet e programit buxhetor të PMNZSH shpenzohen për blerje karburant naftë sasi 3,300 litra në vlerë 526,812 lekë dhe benzinë litra 190 në vlerë 29,942 lekë sipas kontratës shtesë të datës 08.10.2015 me subjektin “K” sha.

C-Zhvillimi i procedurës.

Sipas procesverbalit së datës 04.12.2015 i të hapjes së tenderit rezultojnë se janë ftuar për të marrë pjesë në tender tre subjekte të cilat janë:

a- K. shpk, b- L. shpk, c- K. P. sha.

Ka paraqitur ofertë sipas raportit përfundimtar të klasifikimit dhe vlerësimit të ofertave të datës 04.12.2015 vetëm operatori ekonomik K. shpk me çmim për litër 134,73 lekë pa tvsh, i cili është shpallur fitues pasi ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe dokumentacionin kualifikues dhe ligjor. Sipas këtij raporti përfundimtar rezultojnë se dy operatorët ekonomikë si L. shpk dhe K. P. sha, të ftuar që të marrin pjesë në tender sipas ftesës për ofertë të dërguar me shkresën nr. 1828, dhe me nr. 1829 datë 03.12.2015, nuk kanë paraqitur ofertë më datën 04.12.2015, kur do hapej tenderi.

Njoftimi i fituesit është bërë më datën 04.12.2015 nga ish Sekretari i Përgjithshëm A. J. Kontrata ndërmjet autoritetit kontraktor (prefekti i Qarkut Lezhë), përfaqësuar nga A. J. dhe subjektit K. shpk është lidhur më datën 04.12.2015 në vlerën prej 416,666 lekë pa tvsh. Theksojmë se për periudhën objekt auditimi kryesisht për blerje dhe kryerje të shpenzimeve në institucion është përdorur procedurë “Prokurim me vlerë të vogla”.

Financimi i kontratës i datës 04.12.2015.

Me urdhërpagesën nr. 257, datë 14.12.2015 në shumën prej 499,591 lekë subjekti K. shpk sipas faturës nr. 28, datë 04.12.2015 dhe bërë hyrje në institucion me fletë hyrjen nr. 17, datë 04.12.2015 në sasi 3090 litra naftë në vlerë 499,591 lekë. Theksojmë që kjo pagesë është kryer me fondet e programit buxhetor për PMNZSH me nr. 10910. Në fakt nga dokumentet e paraqitura nga ky sektor për muajin Dhjetor 2015 janë përdorur për nevojat e këtij sektori gjithsej karburant naftë gjithsej 1910 litra në vlerë 308,808 lekë nga 3,090 litra në vlerë 499,591 të kërkuara dhe të blerë për sektorin e PMNZSH. Më datën 01.01.2016 në zbatim të ligjit nr. 152 datë 21.12.2015 “Për shërbimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, ky sektor kalon në varësi të Bashkisë Lezhë.

Rezultojnë gjendje në fund të vitit 2015 sasi naftë 380 litra në vlerë 61,438 lekë dhe 550 litra benzinë në vlerë prej 90,231 lekë, e pa përdorur në magazinën e prefekturës referuar aktrakordimit të mbajtur në magazinën më 11.01.2016 në Institucionin e Prefektit Lezhë nga ish magazinieri e institucionit B. M. dhe S. F. ish shefe e financës dhe N. Z. ish shefi i sektorit të shërbimeve.

Si përfundim përdorimi i fondeve të programuar për PMNZSH për blerje karburanti në fund të vitit nga ana e Institucionit të Prefektit më shumë se nevojat reale të fund vitit për sektorin e PMNZSH tregon për përdorim të tyre pa ekonomikitet, pa efektivitet veprime që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3/pika 2, neni 40 dhe neni 52 dhe ngarkojnë me përgjegjësi A. J. me detyrë ish Sekretarin e Përgjithshëm dhe A. P. me detyrë ish-shef i sektorit të PMNZSH.

7. Auditim mbi funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të titujve të pronësisë.



7. 1. Auditimi mbi mbajtjen e Procesverbalit të mbledhjes, firmosja, problematika, diskutimet dhe votat e dhëna nga anëtarët e Komisionin vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV), për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016.

Komisioni vendor ka funksionuar si **organ kolegjal**, ndërsa mbledhjet janë thirrur dhe drejtuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë. Për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2016, komisioni vendor ka zhvilluar mbledhje duke marrë vendime në lidhje me shfuqizimi të plotë, të pjesshëm, rikonfirmimin, korrigjim dhe rrëzim të AMTP-ve.

I - Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për periudhën 01.01.2013 deri 30.05.2016, procesverbali i mbledhjes **nuk është mbajtur në një libër të sekretuar** me numër fletësh, të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës së Prefektit të Qarkut Lezhë, por procesverbali i mbledhjeve është mbajtur në fletë të shkëputura sipas vendimeve të marra të ankesave, kërkesave, informacioneve të paraqitura nga shtetas dhe strukturat shtetërore, si dhe nga kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet.

Në të gjitha rastet, në procesverbalin e mbledhjes **nuk janë regjistruar problemat e trajtuar nga relatori i çështjes, nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni.** Në procesverbalin e mbledhjes, nga relatori ose grupi i punës, nuk është paraqitur informacion përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektet e interesuara në lidhje me çështjen dhe propozimet përkatëse, **nuk është shprehur forma dhe rezultati i votimit,** nga relatori i çështjes, nuk janë paraqitur në mënyrë kronologjike të gjitha dokumentet që kanë ardhur nga shtetas dhe strukturat shtetërore, apo nga kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet. **Nuk janë përcaktuar arsyet të cilat e bëjnë aktin të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm,** si dhe **nuk janë përcaktuar organet që i kanë lëshuar këto Akte Administrative,** veprim në papajtueshmëri me pikën 4 neni 16, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“ dhe pikën 6 germa **a, b,** të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Në procesverbalin e mbledhjes së komisionit vendor **në asnjë rast nuk janë regjistruar diskutimet e Prefektit, si në hapjen dhe mbylljen e mbledhjeve.** Prefekti i Qarkut, **në asnjë rast nuk rezulton të ketë thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore,** që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, **drejtues të qeverisjes vendore,** të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen në mbledhjen e komisionit vendor, veprim në papajtueshmëri me pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi N. I. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 05.04.2013, B. Z. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 15.02.2016.

II - Komisioni vendor për periudhën 30.05.2016 deri me datë 31.12.2016, procesverbalin e mbledhjes e ka **mbajtur në një libër të sekretuar** me numër fletësh, të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës së Prefektit të Qarkut Lezhë. Në procesverbalin e mbledhjes në të gjitha rastet, **nuk janë regjistruar problemat e trajtuara nga relatori i çështjes, nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

lidhje me çështjen që relatohen në komisioni, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Në procesverbalin e mbledhjes, nga relatori ose grupi i punës, nuk është paraqitur informacion përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektet e interesuara në lidhje me çështjen dhe propozimet përkatëse, **nuk është shprehur forma dhe rezultati i votimit** si dhe nuk janë paraqitur në mënyrë kronologjike të gjitha dokumentet që kanë ardhur nga shtetas dhe strukturat shtetërore apo nga kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet.

Në procesverbal **nuk janë përcaktuar arsyet të cilat e bëjnë aktin të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm**, si dhe **nuk janë përcaktuar organet që i kanë lëshuar këto Akte Administrative**, veprim në papajtueshmëri me pikën 4 neni 16, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“, pikën 6 germa **a, b**, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P. me detyrë Drejtor nga data 15.02.2016 e në vazhdim.

Në procesverbalin e mbledhjes së komisionit vendor **në asnjë rast nuk janë regjistruar diskutimet e Prefektit, si në hapjen dhe mbylljen e mbledhjeve**. Gjithashtu, Prefekti i Qarkut, **në asnjë rast nuk rezulton të ketë thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore**, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, **drejtues të qeverisjes vendore**, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen në mbledhjen e komisionit vendor, veprim në papajtueshmëri me pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohen me përgjegjësi A. P. me detyrë Drejtor nga data 15.02.2016 e në vazhdim.

7.2. Auditimi mbi vendimet e marra nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) për shfuqizimin e pjeshëm të AMTP-ve dhe mos shqyrtimi i tyre, për periudhën 01.01.2013 deri me datë 31.12.2016.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me vendimet e marra nga komisioni vendor nga ankesat, kërkesat, informacionet e paraqitura nga shtetas dhe struktura shtetërore dhe nga kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, rezultojnë se për pavlefshmëri të plotë dhe të pjeshme të AMTP-ve janë marrë **19** vendime me sipërfaqe **184163 m²** dhe janë marrë **5** vendime me vlerë **9,246,767 lekë**, për mbajtësin e parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfutur në kundërshtim me ligjin **pasi këto kanë kryer transaksione financiare**. Komisioni vendor (KV), vendimet i ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Shkodër, ndërsa rezultojnë se në **10 raste** këto vendime janë në proces gjyqësor, sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e vendimeve prerë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016

Nr.	Emëri e mbiemër	Vendim		Njësia vendore	Sipërf. m ²	Vendimi gjykatës	
		Nr.	Datë			Nr.	Datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

1	Gj.	L.	108	29.05.13	Z.	1050	-	Nuk ndodhet
2	N.	Z.	115	02.09.13	T.	4550	-	Nuk ndodhet
3	P.	P.	117	26.08.13	Z.	1646	-	Nuk ndodhet
4	A.	V.	121	05.50.14	Sh.	25500	777/07	08.0514
5	J.	D.	122	05.05.14	L.	10000	934	02.03.17
6	E.	L.	128	30.05.16	M.	18300	5995	14.02.16
7	R.	L.	129	30.05.16	M.	13000	4528	05.10.16
8	I.	K.	130	30.05.16	R.	12300	-	Në proces
9	D.	L.	131	30.05.16	M.	15500	111	24.01.17
10	P.	Ll.	132	30.05.16	M.	6500	-	Në proces
11	Ç.	L.	133	30.05.16	M.	3000	-	Në proces
12	Gj.	Gj.	135	30.05.16	M.	2000	80	20.01.17
13	A.	Gj.	136	30.09.16	M.	20000	-	Ne proces
14	V.	H.	137	18.10.16	I.-Sh.	2000	-	Ne proces
15	K.	K.	138	30.11.16	F.-K.	33000	-	Ne proces
16	V.	Z.	139	30.11.16	D.	3411	-	Ne proces
17	Gj.	N.	140	05.12.16	Sh.	5728	-	Ne proces
18	M.	Ll.	141	05.12.16	Sh.	3000	-	Ne proces
19	Gj.	M.	144	20.12.16	Sh.	3678	-	Ne proces
20	D.	C.	125	12.03.15	I.-L.	-	-	-
21	M.	L.	126	12.03.15	I.-L.	-	-	-
22	V.	L.	127	12.03.15	I.-L.	-	-	-
	Totali					184163		

Nga pasqyra më sipër janë audituar **22 dosjet** në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë mbi vendimet e marra nga komisioni vendor i verifikimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë ku janë konstatuar të meta dhe mangës të cilat po i trajtojmë si më poshtë:

- Dosja e vendimit nr. 108, datë 29.05.2013;

Gj. D.L., banues në fshatin S., Komuna Z., me kërkesë datë 17.11.2009, hyrë në protokollin e Institucionit të Prefektit me nr. 1842, datë 17.11.2009, ka kërkuar nga komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë korigjimin e AMTP-së nr. 17, datë 01.02.1992.

Komisioni vendor shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 29.05.2013, **pra 1230 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë specialiste në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë larguar nga detyra me datë 02.02.2016 dhe N. I. me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 05.04.2013.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë specialiste në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë larguar nga detyra me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

datë 02.02.2016 dhe N. I. me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 05.04.2013.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1621/4, datë 06.11.2012, ka kërkuar nga Gj. D. L., njoftim për plotësim dokumentacioni si: AMTP origjinal, bashkëlidhur plan vendosjen e ngastrës të konfirmuar nga kryetari i Komunës dhe vërtetimin e faktit se keni qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore me datë 01.08.1991 ose punonjës në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, **të konfirmuar me shkresë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.**

Komisioni vendor me shtesë nr. 1842/9, datë 27.05.2011, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.08.1991. DAMT Qarku Lezhë, me shkresë nr. 743, datë 26.04.2012, konfirmon se parcela nr. 18 dhe nr. 37 sipas librit të ngastrave datë 01.08.1991, është në zërin kadastral arë, ndërsa parcela nr. 4 në zërin kadastral **vresht dhe truall.** DAMT Qarku Lezhë, me shkresë nr. 2088/2, datë 03.08.2011, konfirmon se pasuria nr. 18/1 me sipërfaqe 8450 m², është në pronësi të Gj. L., dhe me shkresë nr. 471/1, datë 29.03.2011 konfirmon se norma për frymë në fshatin S., K. Z., është **2500 m² për frymë.**

Komisioni vendor me shkresë nr. 1842/9, datë 27.05.2011, ka kërkuar nga ZVRPP Lezhë, konfirmimin e gjendjes juridike të pasurisë nr. 4/12 sipas AMTP lëshuar në emër të G. D. L.. ZVRPP Lezhë, me shkresë nr. 188/1, datë 30.03.2011, konfirmon se pasuria nr. 4/17 ZK 3502, është me sipërfaqe 3000 m² dhe pasuria nr. 18/1 me sipërfaqe 8450 m², këto pasuri janë në pronësi të G. L., ndërsa pasuria nr. 19/12 me sipërfaqe 1730 m² e llojit **arë është në pronësi shtet.**

K. Z. me shkresë nr. 77/1, datë 01.03.2011, konfirmon se në dispozicion të familjes bujqësore Gj. L. është sipërfaqja 11490 m², ndërsa parcela nr. 19/12 me sipërfaqe 1730 m² është në pronësi shtet, **ndërsa përdoret nga Gj. L..**

Komisioni vendor me shkresë nr. 1842/1, datë 24.01.2011, ka kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, konfirmim për Gj. L. dhe anëtarët e familjes nëse me datë 01.08.1991 ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 ka qenë punonjës në ish-NB.

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk ndodhet **përgjigja e kthyer nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë**, nëse Gj. D. L., ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo punonjës në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtores e Komisionit Vendor larguar nga puna me datë 15.02.2016.

Komisioni vendor me **vendim nr. 108, datë 02.09.2013**, ka vendosur korrigjimin e AMTP nr. 17, datë 01.02.1992 dhe kalimin në pronësi të pasurisë nr. 19/12-A për sipërfaqen **1050 m²**, fshati Spiten, komuna Zejmen, lëshuar në emër të Gj. D. L.

Sipas certifikatës familjare Gj. L. rezulton të jetë banor i fshatit P., ndërsa me datë 01.08.1991 familja e Gj. L. përbëhet nga 5 anëtar, vendlindja Lezhë dhe me AMTP-së nr. 17, datë 01.02.1992, ka marrë 11450 m² tokë bujqësore.

Komisioni vendor ka bërë korrigjimin e AMTP nr. 17, datë 01.02.1992, duke kalimin në pronësi të Gj. L. pasurisë nr. 19/12-A për sipërfaqen **1050 m²** tokë bujqësore pa bërë një hetim të plotë administrative, pasi nuk ka përgjigje nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, ku të vërtetohet se Gj. L., me datë 01.08.1991 ka qenë anëtar në kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 ka qenë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, 4 dhe pikën 3 neni 8, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtor e Komisionit Vendor larguar nga puna me datë 15.02.2016. Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numërtuar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtor e Komisionit Vendor larguar nga puna me datë 15.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 115, datë 02.09.2013;

N. G. N., banues në fshatin T., B. Mirditë, me kërkesë pa datë ardhur në Institucionin e Prefektit me nr. 1758, datë 17.10.2010, ka kërkuar verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP pa numër, datë 16.12.1992 me sipërfaqe 14000 m², lëshuar në emër të N. G. N..

Komisioni vendor shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 02.09.2013, **pra 930 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi N. I. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 05.04.2013, B. Z. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 15.02.2016 dhe R. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor, larguar nga puna me datë 14.03.2014.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi N. I. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 05.04.2013, B. Z. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 15.02.2016 dhe R. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor, larguar nga puna me datë 14.03.2014.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1758/2, datë 19.11.2010, ka kërkuar nga B. Rrëshen, konfirmimin e sipërfaqes së tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991 për familjen e N. G. N. dhe N. M. Z., fshati T., numrin e frymëve me datë 01.08.1991 dhe konfirmimin me datë 01.08.1991 nëse kanë qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 punonjës në ish-NB dhe certifikatën e gjendjes familjare.

B. Rrëshen, me shkresë nr. 5202, datë 01.12.2010, konfirmon se N. G. N., ka qenë anëtar në ish-NB Tarazh, Mirditë dhe është pajisur me AMTP me sipërfaqe 14960 m² tokë arë, 7000 m² pemëtore dhe **250 m² truall** dhe N. M. Z. ka marrë 1850 m² tokë arë dhe **2700 m² truall**.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1758/7, datë 24.04.2013, ka kërkuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.08.1991, për ngastrën nr. 61/9, në AMTP, lëshuar në emër të N. M. Z., fshati T., normën e tokës të ndarë për frymë me datë 01.10.1992, në fshatin Tarazh. DAMT Qarku Lezhë, me shkresë nr. 82/1, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

08.05.2013, konfirmon se parcela nr. 61 në fshatin T., me datë 01.10.1992, ka qenë në zërin kadastral arë dhe norma për frymë në këtë fshat ka qenë 2756 m².

Komisioni vendor me shkresë nr. 1758/7, datë 24.04.2013, ka kërkuar nga ZVRPP Mirditë, konfirmimin e pasurisë nr. 61/9 nëse është e njëjtë me pasuarën nr. 237/11, lëshuar në emër të Ndue M. Z., fshati T.. ZVRPP Mirditë me shkresë nr. 675, datë 13.05.2013, konfirmon se parcela nr. 61/9 **nuk ekziston e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP Mirditë**, ndërsa pasuria nr. 237/11 në AMTP është sipas regjistrimit fillestar.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se komisioni i vendor nuk ka kërkuar nga **Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë**, nëse N. M. Z. me datë 01.08.1991 ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 ka qenë punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 15.02.2016 dhe R. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor, larguar nga puna me datë 14.03.2014.

Komisioni vendor me **vendim nr. 115, datë 02.09.2013**, me sipërfaqe **4450 m²** tokë bujqësore ka vendosur shfuqizimin e pjesëshëm të AMTP pa numër, datë 17.10.1995 në pronësi të N. M. Z., fshati T. dhe **kalimin në pronësi shtet, përfituar më shumë se norma për frymë**, veprim në papajtueshmëri me neni 1 germën a, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me VKM nr. 255, datë 17.10.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Tarazh, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke pajisur me tokë bujqësore përfituar më shumë se norma për frymë 4450 m²** në emër të N. M. Z., **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë që ka detyrimin ligjor, **nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin T.**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 15.02.2016 dhe R. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor, larguar nga puna me datë 14.03.2014.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me Kërkesë Padi i ka kërkuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, shfuqizimin e pjesëshëm të AMTP pa numër, datë 17.10.1995 me sipërfaqe 4450 m² në emër të N. M. Z., **përfituar në kundërshtim me ligjin.**

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje nuk ndodhet vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shfuqizimin AMTP pa numër, datë 17.10.1995 me sipërfaqe 4450 m² në emër të N. M. Z., përfituar në kundërshtim me ligjin, veprim në papajtueshmëri me nenin 8, pika 5, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni vendor me personin fizik i cili ka përdorur tokën në mënyrë ta paligjshme, nuk ka mbajtur një procesverbal ku të përcaktonte se tokën me sipërfaqe **4450 m²** nuk e përdorin por e ka lënë të lirë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

në pronësi shtet. Komisioni vendor tokën që ka kaluar në pronësi të shtetit nuk e ka dorëzuar me procesverbal në DAMT Qarku Lezhë, e cila do të përdoret për kompensimin e ish-pronarëve, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtor e Komisionit Vendor larguar nga puna me datë 15.02.2016 dhe R. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor, larguar nga puna me datë 14.03.2014.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtor, larguar nga puna me datë 15.02.2016 dhe R. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor, larguar nga puna me datë 14.03.2014.

- Dosja e vendimit nr. 117, datë 02.09.2013;

Gj. Z., me kërkesë nr. 1433, datë 28.09.2010, ka kërkuar verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 12168, datë 16.06.1996, me sipërfaqe 14146 m², lëshuar në emër të P. D. P. Komuna Z., me vërtetim nr. 533, datë 22.04.2013, vërteton se P. D. P., është banor i fshatit T. dhe është i njëjti person me P. D. N. dhe me P. D. P.

Komisioni vendor shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 02.09.2013, **pra 1140 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë specialiste në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë 22.02.2016.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë specialiste në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë 22.02.2016.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1433/1, datë 24.01.2011, ka kërkuar nga Komuna Z., konfirmimin e sipërfaqes së tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991 për familjen e P. D. N., fshati T., numrin e frymëve me datë 01.08.1991 dhe konfirmimin nëse P. D. N. ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 punonjës në ish-NB.

Komuna Z. me shkresë nr. 543, datë 23.03.2012, konfirmon se në dispozicion të familjes bujqësore P. D. N. (P.) është një sipërfaqe prej 14314 m², ndërsa P. D. N. (P.) ka qenë anëtar në ish-NB Tresh, familja ka qenë 5 anëtar dhe norma për frymë ka qenë 2500 m².



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk ndodhet **përgjigja e kthyer nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë**, nëse P. D. N. (P.), me datë 01.08.1991 ka qenë anëtar në ish-kooperativës bujqësore apo i me datë 01.10.1992 ka qenë punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Komision vendor me **vendim nr. 117, datë 02.09.2013**, me sipërfaqe **1646 m²** tokë bujqësore ka vendosur shfuqizimin e pjesshëm të AMTP nr. 12168, datë 16.06.1996, lëshuar në emër të P. D. N. (P.), fshati T., komuna Z., **përfiturar më shumë se norma për frymë dhe kalimin në pronësi shtet**, veprim në papajtueshmëri me neni 1 germën a, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me VKM nr. 255, datë 17.10.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.

Sipas certifikatës familjare datë 23.03.2012, familja e P. D. N. (P.), me datë 01.08.1991 përbëhet nga 5 anëtar dhe norma për frymë e tokës bujqësore në fshati T. ka qenë 2500 m², (5 frymë x 2500 m²), duke përfiturar tokë bujqësore më shumë **1664 m²** (14146 m²-12500 m²),

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin T., **ka tejkalluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë bujqësore më shumë se normën për frymë me sipërfaqe 1664 m² kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë që ka detyrimin ligjor, **nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Tresh**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me Kërkesë Padi ka kërkuar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, shfuqizimin e pjesshëm të AMTP nr. 12168, datë 16.06.1996, lëshuar në emër të P. D. N. (P.), për sipërfaqen **1646 m²** përfiturar në kundërshtim me ligjin.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje nuk ndodhet vendimi i Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shfuqizimin AMTP pa numër, datë 17.10.1995 me sipërfaqe 1646 m² në emër të P. D. N. (P.), përfiturar në kundërshtim me ligjin, veprim në papajtueshmëri me nenin 8, pika 5, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni vendor me personin fizik i cili ka përdorur tokën në mënyrë ta paligjshme, nuk ka mbajtur një procesverbal ku të përcaktonte se tokën me sipërfaqe **1646 m² nuk e përdorin por e ka lënë të lirë në pronësi shtet**. Komisioni vendor tokën që ka kaluar në pronësi të shtetit nuk e ka dorëzuar me procesverbal në DAMT në Qarkun Lezhë, e cila do të përdoret për kompensimin e ish-pronarëve, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z. me detyrë ish-Drejtores e Komisionit Vendor larguar nga puna me datë 15.02.2016. Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 121, datë 05.05.2014;

Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Lezhë, me kërkesë nr. 2156/1, datë 28.05.2012, ka kërkuar verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14635, datë 30.05.2007, me sipërfaqe 25500 m², lëshuar në emër të A. T. V. (F. T. V.).

Komuna Sh., me vërtetim datë 19.06.2007, vërteton se në bazë të regjistrimit themeltar nr. 221, të Gjendjes Civile, A. T. V. është i njëjti person me F. T. V.

Komisioni vendor shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 05.05.2014, **pra 600 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1107/1, datë 14.01.2014, ka kërkuar nga Komuna Sh., konfirmimin e sipërfaqes së tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991 për familjen e F. T. N., fshati G.-L. dhe normën për frymë të tokës bujqësore.

Komuna Shënkoll me shkresë nr. 524/1, datë 17.10.2013, konfirmon se në nga KLSH-ja është konstatuar shkelje ligjore në lidhje me regjistrimin e pasurisë nr. 21/4 me sipërfaqe 25500 m² lloji arë, fshati G.-L., AMTP nr. 14635, datë 30.05.1997, në emër të F. T. N..

Komisioni vendor me shkresë nr. 1107/2, datë 14.01.2014, ka kërkuar nga ZVRPP Lezhë, konfirmimin e gjendjes juridike për pasuritë në AMTP lëshuar në emër të F. T. N..

Komisioni vendor me shkresë nr. 1107/2, datë 14.01.2014, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.08.1991 lëshuar në emër të F. N., normën e tokës për frymë në fshatin G.-L.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Komuna Shënkoll me shkresë nr. 238, datë 03.04.2014, konfirmon se pasurisë nr. 10/4 është e njëjtë me pasurinë nr. 21/4 dhe me shkresë nr. 128/1, datë 06.02.2014, konfirmon se parcela nr. 10, në fshatin G.-L. është në zërin kadastral arë dhe norma për frymë e tokës bujqësore ka qenë 4300 m².

K. Sh. me shkresë nr. 57/1, datë 04.02.2014, familja përbëhet nga 6 vatë dhe kryefamiljarë është T.N. V., babai i F. Kjo familje është pajisur me 28674 m² tokë bujqësore dhe 180 m² truall. Ndërsa F. N. është pajisur me 25500 m² tokë bujqësore.

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk ndodhet **përgjigja e kthyer nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë**, nëse F. N. me datë 01.08.1991 ka anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 ka qenë punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Komision vendor me **vendim nr. 121, datë 05.05.2014**, me sipërfaqe **25500 m²** tokë bujqësore ka vendosur shfuqizimin e AMTP nr. 14635, datë 30.05.1997, lëshuar në emër të A. T. V. pasi kjo familje është pajisur me 28674 m² tokë bujqësore dhe **180 m² truall** fshatin G.-L., k. Sh., **duke përfituar më shumë se norma për frymë dhe kalimin në pronësi shtet.**

Nga auditimi rezulton komisioni vendor në vendimin nr. 121, datë 05.05.2014, në AMTP nr. 14635, datë 30.05.1997, nuk ka analizuar **zërin kadastral truall me sipërfaqe 180 m²**, nuk ka bërë një hetim administrativ të plotë duke i shkuar çështjes në themel, **por ka bashkuar zërin kadastral truall me zërin kadastral arë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin G.-L., **ka tejkualuar kompetencat ligjore duke ndarë tokë bujqësore më shumë se normën për frymë** me sipërfaqe **25500 m²** tokë bujqësore, **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin G.-L.**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor larguar nga detyra me datë 15.02.2016 dhe E. G. me detyrë anëtar i komisionit vendor larguar nga puna me datë 22.02.2016.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me Kërkesë Padi ka kërkuar nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, shfuqizimin e AMTP-së nr. 14635, datë 30.05.1997, lëshuar në emër të F. T. N. (A. T. N.) për sipërfaqen **25500 m²** përfituar në kundërshtim me ligjin dhe kalimin në pronësi shtet

Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendim nr. 777/707, datë 08.05.2014, ka vendosur kthimin e ankimit për të plotësuar të metat për kërkesë padisë për konstatimin si absolutisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTIT TE QARKUT LEZHE”

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Grykë-Lumi, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokën bujqësore më shumë se norma për frymë me sipërfaqe 5728 m² kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Grykë-Lumi**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor, Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me Kërkesë Padi i është drejtuar Gjykatë Administrative të Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shfuqizimin e plotë të AMTP nr. 10133, datë 01.06.1995, me sipërfaqe 18128 m² tokë bujqësore dhe truall përfituar në kundërshtim me ligjin dhe kalimin në pronësi shtet.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje nuk ndodhet vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, **por është në proces gjyqësor.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor, Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

- Dosja e vendimit nr. 141, datë 05.12.2016;

Gj. M. M. nga fshati Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, me kërkesë datë 11.07.2016, protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr. 956, datë 11.07.2016, ka kërkuar nxjerrjen e Aktit Administrativ në zbatim të vendimit nr. 138, datë 22.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, në favor të shtetasit Gj. M. M., fshati Grykë-Lumi, Bashkia Lezhë.

Komisioni vendor shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 30.09.2013, **pra 450 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor, Gj.N. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor, Gj. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Komisioni vendor me shkresë nr. 834/3, datë 24.11.2016, ka kërkuar nga Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Shënkoll konfirmimin e sipërfaqes së tokës bujqësore për tu ndarë me datë 01.08.1991 për familjen e M. Z. Ll., certifikatën e gjendjes familjare dhe normën e tokës bujqësore për frymë me datë 01.08.1991.

Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Shënkoll, me shkresë nr. 2446/1, datë 02.12.2016, konfirmon se familja e M. Z. Ll., sipas AMTP nr. 14743, datë 21.01.2002, është trajtuar me 1750 m² tokë bujqësore, **ndërsa pasuria nr. 9/27 nuk ndodhet në këtë AMTP.**

Komisioni vendor me shkresë nr. 834/3, datë 24.11.2016, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.08.1991 lëshuar në emër të M. Z. Ll., fshati Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shenkoll dhe normën e tokës të ndarë për frymë. DAMT Qarku Lezhë, me shkresë nr. 1368/1 datë 30.11.2016, konfirmon se parcela nr. 9/2 ndodhet në zëri kadastral arë, ndërsa norma për frymë e tokës bujqësore në fshatin Grykë-Lumi ka qenë 4300 m².

Komisioni vendor me shkresë nr. 927/2, datë 19.09.2016, ka kërkuar nga ZVRPP Lezhë, konfirmimin e gjendjes juridike për pasuritë e AMTP në emër të M. Z. Ll. ZVRPP Lezhë, me shkresë nr. 6314/2, datë 20.10.2016, konfirmon se pasuria nr. 62/24, volum 3, faqe 17 me **sipërfaqe 200 m² truall**, pasuria nr. 76/26 me sipërfaqe 1750 m² arë sipas AMTP nr. 14743, datë 21.01.2002



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

dhe pasuria nr. 11/71 me sipërfaqe 3000 m² arë sipas AMTP nr. 9188, datë 14.11.2002, të cilët janë pajisur me certifikatë pronësie.

Komisioni vendor nuk ka kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, konfirmim nëse M. Z. Ll. apo anëtar të tjerë të familjes me datë 01.08.1991, ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992, kanë qenë punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. . Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor, Gj. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Komision vendor me **vendimin nr. 141, datë 05.12.2016**, ka vendosur deklarin e pavlefshmërisë së plotë ligjore të AMTP nr. 14769, datë 21.01.2002, me sipërfaqe **3000 m²** lëshuar në emër të M. Z. Ll., fshati Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll dhe **kalimin në pronësi shtet**.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Grykë-Lumi, **ka tejkuluar kompetencat ligjore duke ndarë tokën bujqësore më shumë se norma për frymë**, me sipërfaqe **3000 m²**, **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Grykë-Lumi**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor, Gj. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me Kërkesë Padi i është drejtuar Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shfuqizimin e plotë të AMTP nr. 14743 datë 21.01.2002 me sipërfaqe 3000 m², përfutur në kundërshtim me ligjin dhe kalimin në pronësi shtet.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje nuk ndodhet vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, **por është në proces gjyqësor**.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Xh. G. me detyrë anëtare e komisionit vendor, Gj. N. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe K. M., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

- Dosja e vendimit nr. 144, datë 30.11.2016;

M. Gj. Gj. banues në Shënkoll Lezhë, me kërkesë pa datë protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr. 864, datë 5.06.2011, ka kërkuar pavlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 11557, pa datë, me sipërfaqe 3678 m², lëshuar në emër të Gj. M., fshati Shënkoll, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.

Komisioni vendor shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 30.09.2013, **pra 1440 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe Xh. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe Xh. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1027/4, datë 21.08.2010, ka kërkuar nga Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, konfirmimin e sipërfaqes së tokës bujqësore për tu ndarë me datë 01.08.1991 për familjen e Gj. M., fshati Shënkoll, certifikatën e gjendjes familjare dhe normën e tokës bujqësore për frymë me datë 01.08.1991.

Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Shënkoll, me shkresë nr. 373, datë 19.08.2010, konfirmon se familja e Gj. M., fshati Shënkoll, me datë 01.08.1991 ka qenë 5 frymë dhe norma për frymë ka qenë 3200 m² ndërsa me AMTP nr. 1557, pa datë ka përfutuar 19875 m² tokë bujqësore.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1027/1, datë 14.07.2014, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.10.1992 lëshuar në emër të Gj. M., fshati Shënkoll, në lidhje me AMTP nr. 1557, pa datë. DAMT Qarku Lezhë, me shkresë nr. 1644/1 datë 12.08.2010, konfirmon se parcela nr. 67, nr. 83 dhe nr. 86 ndodhet në zëri kadastral arë.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1027/1, datë 14.07.2010, ka kërkuar nga ZVRPP Lezhë, konfirmimin e gjendjes juridike për pasuritë që ndodhen në AMTP nr. 1557, pa datë, lëshuar në emër të Gj. M.. ZVRPP Lezhë me shkresë nr. 1387/1, datë 27.07.2010, konfirmon se pasuria nr. 67/5, volum 2, faqe 59 me sipërfaqe 16224 m², nr. 83/1, volum 5, faqe 148, me sipërfaqe 320 m² dhe nr. 86/2, volum 2, faqe 60, me sipërfaqe 1852 m².

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se komisioni vendor nuk ka kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, konfirmim nëse Gj. M., apo anëtar të tjerë të familjes me datë 01.08.1991, ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe Xh. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Komision vendor me **vendim nr. 144, datë 20.12.2016**, ka vendosur deklarimin e pavlefshmërisë së plotë ligjore të AMTP nr. 1557, pa datë, me sipërfaqe **3678 m²** lëshuar në emër të Gj. M., fshati Shënkoll dhe **kalimin në pronësi shtet**.

Sipas certifikatës familjare datë 01.08.1991, familja e Gj. M. përbëhet nga 5 frymë dhe norma për frymë në fshatin Shënkoll ka qenë 3200 m², kjo familje duhet të përfitonte një sipërfaqe prej 16000 m² tokë (5 frymë x 3200 m²), ndërsa ka përfutuar një sipërfaqe prej **3678 m² tokë bujqësore më**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

shumë se norma për frymë (19875 m²-16000 m²), veprim në papajtueshmëri me neni 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me neni 1 germën **a**, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me VKM nr. 255, datë 17.10.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Shënkoll, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokën bujqësore më shumë se norma për frymë**, me sipërfaqe **3678 m²** lëshuar në emër të Gj. M., **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Shënkoll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe Xh. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

Prefekti i Qarkut Lezhë, me Kërkesë Padi i është drejtuar Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për shfuqizimin e plotë të AMTP nr. 1557, pa datë, me sipërfaqe **3678 m²** tokë bujqësore në pronësi të Gj. M., fshati Shënkoll, përfituar në kundërshtim me ligjin dhe **kalimin në pronësi shtet**.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje nuk ndodhet vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, **por është në proces gjyqësor**.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe Xh. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor.

- Dosja e vendimit nr. 125, datë 12.03.2015;

A. M. banues në Lezhë, me kërkesë pa datë protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr. 1432, datë 02.07.2014, ka kërkuar pavlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 14721/1, datë 27.04.2004 me sipërfaqe 8500 m², lëshuar në emër të D. C., fshati Grykë-Lumi, Bashkia Lezhë.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1432/1, datë 07.07.2004, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.08.1991 lëshuar në emër të D. C., fshati Grykë-Lumi, në lidhje me AMTP nr. 14721/1, datë 27.04.2004 me sipërfaqe 8500 m². DAMT Qarku Lezhë, konfirmon se sipas librit të ngastrave datë 01.08.191 parcela nr. 98, është në zëri kadastral **Pyll** me sipërfaqe të përgjithshme 235200 m², fshati Ishull-Lezhë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

ZVRPP Lezhë me shkresë nr. 1432/3, datë 10.10.2014, konfirmon se në emër të Domenika Ceraj në KPP është regjistruar pasuria nr. 105/1, volum 20, faqe 57, ZK 1986 Ishull-Lezhë, arë me sipërfaqe 8500 m², ku sipas kontratës së shitjes ka kaluar pronësi të M. P. K., janë kryer transaksione financiare për shit-blerjen e pasurisë.

Sa sipër rezulton se parcela nr. 98, në AMTP nr. 14721/1, datë 27.04.2004, ndodhet fshati Grykë-Lumi, ndërsa sipas dokumentacionit në dosje ndodhet në fshatin Ishull-Lezhë, **zëri kadastral Pyll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 125, datë 12.03.2015**, ka vendosur deklarimin e pavlefshmërisë së plotë ligjore të AMTP nr. 14721/1, datë 27.04.2004 me sipërfaqe 8500 m² tokë bujqësore lëshuar në emër të D. C., përfituar në kundërshtim me ligjin dhe detyrimin D. C. që të paguaj vlerën **1,343,000 lekë**, llogaritur sipas hartës së vlerës miratuar me VKM nr. 514, datë 30.07.014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni vendor nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin D. C., arkëtimin e vlerës **1,343,000 lekë**. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Ishull-Lezhë, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokën bujqësore më kundërshtim me ligjin** me sipërfaqe 4500 m² lëshuar në emër të D. C., **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Ishull-Lezhë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

- Dosja e vendimit nr. 126, datë 12.03.2015;

A. M. banues në Lezhë, me kërkesë pa datë protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr. 1432, datë 02.07.2014, ka kërkuar pavlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 8622, datë 19.07.2003 me sipërfaqe 21766 m², lëshuar në emër të M. P. L., fshati Grykë-Lumi, Bashkia Lezhë.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1432/1, datë 07.07.2014, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral me datë 01.08.1991 lëshuar në emër të M. P. L., fshati Grykë Lumi, në lidhje AMTP nr. 8622, datë 19.07.2003 me sipërfaqe 21766 m². DAMT Qarku Lezhë, konfirmon se sipas librit të ngastrave datë 01.08.191 parcela nr. 98, **zëri kadastral Pyll** me sipërfaqe të përgjithshme 235200 m², fshati Ishull-Lezhë.

ZVRPP Lezhë me shkresë nr. 1432/3, datë 10.10.2014, konfirmon se në emër të M. P. L. në KPP është regjistruar pasuria nr. 105/4, volum 20, faqe 61 ZK 1986 Ishull-Lezhë, arë me sipërfaqe 16000 m² me kontratë shitjes ka kaluar pronësi të A. Sh. Xh., pasuria nr. 105/8, volum 20, faqe 74, arë me sipërfaqe 5766 m² me kontratë shitje ka kaluar pronësi të L. M. N., pra janë kryer transaksione financiare në lidhje me shit-blerjen e këtyre pasurive.

Sa sipër rezulton se parcela nr. 98, në AMTP nr. 8622, datë 19.07.2003, ndodhet fshati Grykë-Lumi, ndërsa sipas dokumentacionit në dosje ndodhet në fshatin Ishull-Lezhë, **zëri kadastral Pyll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 126, datë 12.03.2015**, ka vendosur deklarin e pavlefshmërisë së plotë ligjore të AMTP nr. 8622, datë 19.07.2003 me sipërfaqe 21766 m² tokë bujqësore lëshuar në emër të Marjan Preng Luka, përfituar në kundërshtim me ligjin dhe detyrimin M. P. L. që të paguaj vlerën **3,439,028 lekë**, llogaritur sipas hartës së vlerës miratuar me VKM nr. 514, datë 30.07.014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni vendor nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin M. P. L., arkëtimin e vlerës **3,439,028 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Ishull-Lezhë, **ka tejkualuar kompetencat ligjore duke ndarë tokën bujqësore me sipërfaqe 21766 m² më kundërshtim me ligjin, kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Ishull-Lezhë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

- Dosja e vendimit nr. 127, datë 12.03.2015;

A. M. banues në Lezhë, me kërkesë pa datë protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr. 1432, datë 02.07.2014, ka kërkuar pavlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 14913, datë 14.04.2003 me sipërfaqe 21797 m², lëshuar në emër të V. P. L., fshati Grykë Lumi, Bashkia Lezhë.

Në auditimi rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Komisioni vendor me shkresë nr. 1432/1, datë 07.07.2014, ka kërkuar nga DAMT Qarku Lezhë, konfirmimin e zërit kadastral datë 01.08.1991 lëshuar në emër të V. P. L., fshati Grykë- Lumi, në lidhje AMTP nr. 14913, datë 14.04.2003 me sipërfaqe 21797 m². DAMT Qarku Lezhë, konfirmon se sipas librit të ngastrave datë 01.08.191 parcela nr. 98, **zëri kadastral Pyll** me sipërfaqe të përgjithshme 235200 m², fshati Ishull-Lezhë.

ZVRPP Lezhë me shkresë nr. 1432/3, datë 10.10.2014, konfirmon se në KPP është regjistruar në emër të V. P. L. pasuria nr. 105/6, e cila është ndarë në:

- pasurinë nr. 105/12, volum 20, faqe 79 arë me sipërfaqe 5000 m², sipas kontratës së shitjes ka kaluar pronësi të M. Gj. P.;

- pasuria nr. 105/16, volum 20, faqe 146, arë me sipërfaqe 5000 m² sipas kontratës së shitjes ka kaluar pronësi të R. A. S.;

- pasuria nr. 105/17, volum 20, faqe 147, arë me sipërfaqe 5000 m² sipas kontratës së shitjes ka kaluar pronësi të L. Z. N.;

- pasuria nr. 105/18, volum 20, faqe 148, arë me sipërfaqe 4000 m² sipas kontratës së shitjes ka kaluar pronësi të L. M. N.;

- pasuria nr. 105/19, volum 20, faqe 149, arë me sipërfaqe 9280 m² sipas kontratës së shitjes ka kaluar pronësi të L. F. F.;

- pasuria nr. 105/20, volum 20, faqe 152, arë me sipërfaqe 6483 m² regjistruar në pronësi shtet. Ndërmjetë palëve janë kryer transaksione financiare në lidhje me ndarjen dhe shit-blerjen e kësaj pasurie.

Sa sipër parcela nr. 98, në AMTP nr. 14913, datë 14.04.2003 me sipërfaqe 21797 m², ndodhet në fshati Grykë-Lumi, ndërsa sipas dokumentacionit në dosje kjo pasuri ndodhet në fshatin Ishull-Lezhë, **në zërin kadastral Pyll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 126, datë 12.03.2015**, ka vendosur deklarinimin e pavlefshmërisë së plotë ligjore të AMTP nr. 14913, datë 14.04.2003 me sipërfaqe 21797 m² tokën bujqësore lëshuar në emër të V. P. L., përfituar në kundërshtim me ligjin dhe detyrimin V. P. L. të paguaj vlerën **3,443,926**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

lekë, llogaritur sipas hartës së vlerës miratuar me VKM nr. 514, datë 30.07.014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni vendor nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfutur në kundërshtim me ligjin V. P. L., arkëtimin e vlerës **3,443,926 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Ishull-Lezhë, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokën bujqësore me sipërfaqe 21797 m² në kundërshtim me ligjin, kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Ishull-Lezhë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor i komisionit vendor, P. H. me detyrë anëtar i komisionit vendor dhe N. G., me detyrë anëtare e komisionit vendor larguar nga puna larguar nga puna me datë 01.12.2015.

7.3 - Mbi auditimin e vendimeve të marra për rikonfirmim e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP).

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për ankesat dhe kërkesat e paraqitura nga shtetas dhe struktura shtetërore, në lidhje me pronësinë mbi tokën bujqësore dhe veprimtarinë e kryer nga ish-komisionet e ndarjes së tokës rezulton se nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016, janë marrë **12** vendime, për rikonfirmim, AMTP, për sipërfaqen **134083 m²**, si më poshtë:

Pasqyra e vendimeve Rikonfirmim AMTP për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016

Nr.	Emëri e mbiemër		Vendim		Sipërfaqja Në m ²	Njësia vendore
			Nr.	Datë		
1	T.	G.	104	29.5.2013	4000	Shënkoll
2	R.	H.	109	29.05.2013	3000	Shënkoll
3	F.	P.	111	29.5.2013	3000	Shënkoll
4	N.	N.	112	11.7.2013	8011	Shënkoll
5	G.	F.	113	11.7.2013	3000	Shënkoll
6	T.	J.	114	02.9.2013	11500	Shënkoll



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

7	N.	D.	118	16.9.2013	3000	Shënkoll
8	R.	Gj.	119	07.02.2014	2000	Shënkoll
9	N.	L.	120	07.02.2014	44900	Shënkoll
10	L.	N.	123	06.10.2014	5003	Shënkoll
11	M.	N.	143	30.11.2016	9000	Shënkoll
12	N.	N.	142	13.12.2016	37669	Shënkoll

Nga pasqyra më sipër u audituan dosjet përkatëse që lidhen me 11 vendimet e marra nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për rikonfirmim të AMTP për sipërfaqen **96414 m²**, pasi vendimi nr. 142, datë 13.12.2016 me shkresë nr. 1699, datë 13.12.2016 është dërguar pranë Komisionit Qeveritarë të tokës për konfirmim, të cilat po i trajtojmë më poshtë:

- Dosja e vendimit nr. 104, datë 29.05.2013;

Me kërkesë datë 16.09.2010, F. K. V. banues në fshatin Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, ka kërkuar nga komisioni vendor deklarimin e pavlefshmërisë së pjesshme të sipërfaqes 4000 m² të AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 17981 m²; parcela nr. 37/19, me sipërfaqe 1386 m², parcela nr 32/3, me sipërfaqe 4495 m², parcela nr 28/7, me sipërfaqe 7600 m², parcela nr 9/2/19, me sipërfaqe 4000 m², lëshuar në emër të T. P. Gj.

Komisioni vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 29.05.2013, **pra 2 vite e 8 muaj më vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuar, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 104, datë 29.05.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 12760, datë 30.05.1997, me **sipërfaqe 17981 m²**, lëshuar në emër të T. P. Gj., fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll.

Komisioni i vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresë nr. 361/7, datë 16.06.2010, kërkesë për informacion drejtuar ZVRPP Lezhë i kërkon gjendjen juridike të pronës në parcelën nr.11 dhe transaksionet e kryera për pasuritë në parcelën nr. 11.

ZVRPP Lezhë me shkresë 1177/1, datë 30.06.2010 kthen përgjigje se pasuria me nr. 11/20 Zk. 1879 rezulton në emër të Tonin Preng Gjini ku informon se për pasurinë nr. 11/20 zk. 1879, përfituar me AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997, rezulton se KLSH ka rekomanduar **kufizimin e kësaj pasurie**.

Sipas dokumentacionit në dosje T. P. Gj.dhe familja e tij kan qenë banor të Komunës Shënkoll, me datë 01.08.1991. Norma për frymë e tokës në fshatin gryk Lumi ka qenë 4300 m². Sipas certifikatës familja përbëhet nga 3 frymë e duhet të përfitonte 12900 m² tokë bujqësore (3 frymë x 4300 m²). Sipas AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997 ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 17981 m², lëshuar në emër të T. P. Gj., ku sipas shkresës nr 238, datë 24.5.2013 të ish komunës Shënkoll me lëndë: kthim Përgjigje, drejtuar: Komisionit Vendorë të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë prefektura Lezhë, ku thuhet se familja bujqësore T. P. Gj.për parcelat nr 32/3, me sipërfaqe 4495 m²dhe parcela nr 28/7,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

me sipërfaqe 7600 m² është llogaritur sipërfaqe më tepër sepse këto toka **janë me bonitet të ulët**, përfituar më shumë **5081 m²** (17981 m²-12900 m²), këto toka nuk ndahen si toka bujqësore, pasi janë toka pa fryt (PF). Ndërsa trajtimi sipas pikës 5, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar, kemi të bëjmë me toka mbi ujë por që janë toka PF pasi këto toka nuk janë ndarë me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, të ndryshuar.

Sa më sipër komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të** Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 12760, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 17981 m², lëshuar në emër të z. T. P. Gj., **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP**, pasi komisioni i ndarjes së tokë në fshat ka ndarë tokë pa frytë (PF), veprim në papajtueshmëri me nenin 2, pikën 3 neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Grykë-Lumi, **ka tejkalluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë më shumë se norma për frymë, si dhe ka nadržë tokë pa fryt (PF, kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Grykë-Lumi Komuna Shënkoll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi Renato Nikaj, me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 109, datë 29.05.2013;

Me kërkesë të F. K. V. banues në fshatin Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin e vlefshmërisë të AMTP nr. 14685, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; parcela nr 11/2/13, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të Rr. Gj. H., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuar, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 109, datë 29.05.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 14685, datë 22.01.2001, **me sipërfaqe 3000 m²**, lëshuar në emër të Rr. Gj. H., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresë nr. 361/7, datë 16.06.2010, kërkesë për informacion drejtuar ZVRPP Lezhë i kërkon gjendjen juridike të pronës në parcelën nr. 11 dhe transaksionet e kryera për pasuritë në parcelën nr. 11.

ZVRPP Lezhë me shkresë 1177/1, datë 30.06.2010 kthen përgjigje se pasuria me nr. 11/36 Zk. 1879 rezulton në emër të Rr. Gj. H. dhe me shkresë nr. 2706, datë 27.10.2011 i drejtohet komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë ku sqaron se për pasurinë nr. 11/36 zk. 1879, vol. 4, faqe 159, përfituar me AMTP nr. 14685, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², rezulton se KLSH ka rekomanduar **kufizimin e kësaj pasurie**.

Sa më sipër komisioni vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të** Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 14685, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të Rr. Gj. H., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të** Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr. 14685, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², **pasi këto psasuri janë kufizuar nga KLSH**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtorë i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 111, datë 29.05.2013;

Me kërkesë nr. 158, datë 25.01.2013 të ZVRPP Lezhë, ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin vlefshmërisë të AMTP nr. 14691, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; parcela nr 11/2/19, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të F. P., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Sipas kartelës shoqërues të zyrës së protokollit kërkesa është regjistruar me datë 25.01.2013, ndërsa komisioni vendor kërkesën e ka shqyrtuar me datë 29.05.2013, **pra 124 dit më vonë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 111, datë 29.05.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14691, datë 22.01.2001, me sipërfaqe **3000 m²**, lëshuar në emër të F. P., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Sipas dokumentacionit në dosje F. P. dhe familja e tij kanë përfituar tokë si familje të përmbytura nga ndërtimi i Heceve në komunën Shënkoll fshati Barbullonjë.

Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresë nr. 150/1, datë 29.01.2013 , kërkesë për informacion drejtuar ZVRPP Lezhë i kërkon gjendjen juridike aktuale



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

të ngastrave, të pasqyruara në AMTP lëshuar në emër të familjes F. P. Me shkresë nr 208/1, datë 17.05.2013 ZVRPP Lezhë informon se pasuria nr 11/42, v. 4, fq. 166 që ndodhet në ZK. 1879 rezulton e regjistruar në emër të F. P. me sipërfaqe 3000 m² në bazë të AMTP nr. 14691, datë 22.01.2001.

Komisioni vndorë me shkresë nr. 150/1, datë 29.01.2013, kërkesë për informacion drejtuar Komunës Shënkoll ku i kërkon informacion për sipërfaqen e tokës së vënë në dizpozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991 për ish- Kooperativat bujqësore dhe me datë 01.10.1992 për ish-N.Bujqësore, numri i frymëve të fshatit Gryk Lumi me datë 01.08.1991 për ish- Kooperativat bujqësore dhe me datë 01.10.1992 për ish-N.Bujqësore dhe norma e tokës në m² për frymë.

Komuna Shënkoll me shkresë nr.123, datë 18.03.2013 kthen përgjigje se familja e F. P. është paisur me tokë në zbatim të VKM nr. 306, datë 30.06.1994 “Per masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i Hidrocentraleve në rrethet Kukes, Has, Tropoje dhe Puke” me normën për frymë 750 m² ku sipas pikës 4 të VKM nr. 306, datë 30.06.1994 përcaktohet se..... *Ndarja e tokës ne rrethet pritëse dhe zbatimi i ketij vendimi bëhet mbi bazën e dispozitave ekzistuese për tokën nga komisioni i tokave dhe pushteti lokal në rrethin pritës.*

Sipas certifikatës së gjendjes familjare të vitit 1994 të lëshuar nga gjendja civile Fush Arrëz familja e F. P. është e përbërë nga 3 perona dhe duhet të merrte sipas normës për frymë 2250 m² tokë kur në fakt kjo familje është paisur me AMTP nr. 14691, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², pra përfiturar më shumë **750 m²** (3000 m²-2250 m²).

Sa më sipër komisioni vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit** të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr 14691, datë 22.01.2001, lëshuar në emër të F. P., fshatit Barbullonjë, Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute** të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr. 14691, datë 22.01.2001 me sipërfaqe 3000 m², pasi ka përfiturar tokë mbi normën për frymë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Barbullonjë, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë më shumë se norma për frymë.** Pajisja me tokë bujqësore dhe dhënien e titullit të pronësisë (AMTP), **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Barbullonjë Komuna Shënkoll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 112, datë 11.07.2013;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Me kërkesë të N. Rr. Gj. banuese në fshatin Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin të AMTP nr. 13887, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 8011 m²; parcela nr 11/36, me sipërfaqe 4011 m², parcela nr 9/2/6, me sipërfaqe 4000 m², lëshuar në emër të N. Rr. Gj., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni vendor me **vendim nr. 112, datë 11.07.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi me nr. 13887, datë 30.05.1997, **me sipërfaqe 8011 m²** lëshuar në emër të N. Rr. Gj., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Sipas dokumentacionit në dosje Komisioni Vendor me shkresë nr. 1032/2, datë 21.02.2012 me anë të së cilës kërkon informacion Komunes Shënkoll për sipërfaqen e tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991, certifikatën e gjendjes familjare sipas gjendjes civile me datë 01.08.1991 dhe normën për frymë. Me shkresën. 671/1, datë 13.11.2012 Komuna Shënkoll kthen përgjigje se N. Rr. Gj. dhe familja e tij nuk janë banorë të fshatrave të Komunës Shënkoll, me shkresë nr. 214, datë 08.05.2013 konfirmon se me datë 01.08.1991, sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësorë Lezhë nr. 195, datë 06.03.2012 kjo familje ka qenë banore e datës 01.08.1991, kur në fakt sipas certifikatës së gjendjes civile Laç familja e z. N. Rr. Gj. më datë 01.08.1991 janë banor të fshatrave të Laçit.

Komisioni Vendor me shkresë nr. 1032/2, datë 21.02.2012 me anë të së cilës kërkon informacion për gjendjen juridike të pasurive të pasqyruara në AMTP për pasuritë me nr. 13887, datë 30.05.1997 lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll. Me shkresë nr. 415/1, datë 04.04.2012, ZVRPP Lezhë informon se AMTP nr. 13887, datë 30.05.1997, me sipërfaqe **8011 m²**; parcela nr 11/36, vol. 4 fq. 106 me sipërfaqe 4011 m² rezulton në emër të N. Rr. Gj. ndërsa pasuria me sipërfaqe 4000 m² nuk mund ta identifikojmë. Me shkresë nr. 415/2, datë 05.07.2013, ZVRPP Lezhë kthen përgjigje pas plan rievimit të paraqitur nga z. N. Rr. Gj. për pasurinë nr. 11/7 me sipërfaqe 4000 m² ku konfirmon se në regjistrat e pasurive të paluajtshme, zona kadastrale nr. 1879, vol 5, faqe 5 rezulton të jetë pronë shtetërore.

Nga auditimi u konstatua se mungonte dokumentacioni sipas kërkesave të VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë” (KV).

Sa më sipër komisioni vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit** të AMTP nr. 13887, datë 30.05.1997, të Nik Rrok Gjonikaj lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute** të AMTP nr. 13887, datë 30.05.1997, të N. Rr. Gj. lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll, PASI nuk ka qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore me datë 01.08.1991, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Gryk Lumi, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë për familje të cilat nuk kanë qenë banorë të ish-kooperativës bujqësore me datë 01.08.1991, kanë sjellë, për pasojë,**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 113, datë 11.07.2013;

Me nismën e vet komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë ka bërë verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14690, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; parcela nr 11/2/18, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të G. P. F., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 113, datë 11.07.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14690, datë 22.01.2001, **me sipërfaqe 3000 m²**, lëshuar në emër të G. P. F., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi u konstatua se mungonte dokumentacioni sipas kërkesave të VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë” (KV).

Sa më sipër komisioni vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit** të AMTP nr. 14690, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; parcela nr 11/2/18, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të G. P. F., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 14690**, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të G. P. F., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, pasi nuk ka konfirmim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, veprim në papajtueshmëri me pika 3, nenin 8 dhe pika 1, neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtore e komisionit vendor larguar nga puna me datë 05.02.2016.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtoreshë e komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri më 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 114, datë 26.08.2013;

Me shkresë nr. 70/1, datë 19.03.2013, ZVRPP Lezhë, ka kërkuar nga komisioni vendor konfirmimin e vlefshmërisë të AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 11500 m²; parcela nr 21/6, me sipërfaqe 11500 m², lëshuar në emër të T. Ll. J., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuar, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, **mungonte dokumentacioni** sipas kërkesave të VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë” (KV).

Komision vendor me **vendim nr. 114, datë 26.08.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr. 3587, datë 30.05.1997, **me sipërfaqe 11500 m²**, lëshuar në emër të T. Ll. J. fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresë nr. 373/1, datë 25.03.2013, kthim përgjigje drejtuar ZVRPP Lezhë i kërkon më shumë informacion me qëllim verifikimin e AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997.

ZVRPP Lezhë me shkresë 712/1, datë 08.04.2013, në vijim të shkresë nr. 373/1, datë 25.03.2013, i rikërkon komisionit vendor verifikimin e AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997, për arsye se: AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997 nuk është e depozituar në arkivin e vet, sipërfaqja e dhënë në AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997 për sipërfaqen 11500 m² nuk përputhet me numrin e frymëve me datë 01.08.1991, kjo pasuri nuk rezulton e hapur në kartelat e pasurisë dhe se KLSH ka konstatuar mangësi ligjore dhe se vulat në AMTP nuk dallohen.

Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresë nr. 373/1, datë 25.03.2013, i drejtohet Komunës Shënkoll për kërkesë për informacion për pajisjen me tokë të familjes T. Ll. J. Komuna Shënkoll me shkresë nr. 264, datë 31.05.2013 kthen përgjigje se familja e T. Ll. J. me datë 01.08.1991 ka qenë me 2 anëtarë, norma e tokës për frymë është 3700 m², sipas certifikatës familja përbëhet nga 2 frymë e duhet të përfitonte 7400 m² tokë bujqësore (2 frymë x 3700 m²). Sipas AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997 ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 11500 m², lëshuar në emër të T. Ll. J., ku sipas shkresës nr. 264, datë 31.05.2013 kthen përgjigje se familja e z. T. Ll. J. me datë 01.08.1991 ka qenë me 2 antarë, norma e tokës për frymë është 3700 m² dhe se toka e ndarë është me **bonitet të ulët**, përfituar më shumë **4100 m²** (11500 m²-7400 m²), këto toka nuk ndahen si toka bujqësore, pasi janë toka pa fryt (PF). Ndërsa trajtimi sipas pikës 5, të VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar, kemi të bëjmë me toka mbi ujë por që nuk janë toka PF pasi këto toka nuk janë ndarë me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, të ndryshuar.

Sa më sipër komisioni vendor pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr. nr. 3587, datë 30.05.1997, lëshuar në emër të T. Ll. J., fshatit Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, por duhet të**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr. 3587, datë 30.05.1997 pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka ndarë tokë pa fryt (PF), e cikla nuk ka qenë objekt i ligjit për tokën, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Sa më sipër Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Gryk Lumi, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë më shumë se norma për frymë. Pajisja me tokë bujqësore dhe dhënien e titullit të pronësisë (AMTP), **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit,** ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll,** veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.**

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi R.N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtores i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 118, datë 09.09.2013;

Me kërkesë pa datë të D. D., ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin vlefshmërisë të AMTP nr. 14689, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; lëshuar në emër të N. D. D., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Sipas kartelës shoqëruar të zyrës së protokollit kërkesa është regjistruar me nr. 617, datë 28.05.2013, ndërsa komisioni vendor kërkesën e ka shqyrtuar me datë 09.09.2013, **pra 102 dit më vonë,** veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 118, datë 09.09.2013** dhe ka vendosur rikonfirmimin e e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14689, datë 22.01.2001, **me sipërfaqe 3000 m²** lëshuar në emër të N. D. D., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi u konstatua se mungonte dokumentacioni sipas kërkesave të VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë” (KV). Në dosje mungojnë të dhëna (certifikata e gjendjes familjare me datë 01.08.1991 ose 01.10.1992) për familjen N. D. D. në fshatin Iball Pukë ku për këtë kërkesë të ligjit komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë i është referuar çertifikatës së gjendjes Civile Shënkoll me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

datë 01.08.1995, mungon dokumentacioni që vërteton se sa tokë ka përfituar familja e tij në fshatin Iballë të Pukës në vitin 1991, sepse sipas pikës 4 të VKM nr. 306, datë 30.06.1994.

Sa më sipër komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit** të AMTP nr. 14689, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; lëshuar në emër të N. D. D., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute** të AMTP nr. 14689, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m² lëshuar në emër të N. D. D., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, pasi munguan dokumentacioni nga fshati Iballë Pukë, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 119, datë 07.02.2014;

Me kërkesë pa numër e pa datë, protokolluar në Prefekturën Lezhë me nr. 1300, 09.12.2013, R. Gj. Gj. banues në fshatin Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin e AMTP nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m²; parcela nr 11/2/15, me sipërfaqe 2000 m², lëshuar në emër të R. Gj. Gj., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuar, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 119, datë 07.02.2014** dhe ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së tokës në pronësi nr. 14687, datë 22.01.2001, **me sipërfaqe 2000 m²**, lëshuar në emër të R. Gj. Gj., fshatit Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresë nr. 1300/1, datë 11.12.2013, kërkesë për informacion drejtuar ZVRPP Lezhë i kërkon gjendjen juridike të ngastrave të pasqyruara në Aktin e Marrjes së tokës në pronësi të R. Gj. Gj. me nr. me sipërfaqe 2000 m², lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll.

ZVRPP Lezhë me shkresë 3057, datë 06.01.2014 kthen përgjigje se pasuria me nr. 11/38, volum 4, fq. 161, Zk. 1879 rezulton në emër të R. Gj. Gj., përfituar me AMTP nr. 14687, datë 20.01.2001.

Komisioni i vendorë me shkresë nr. 1300/1, datë 11.12.2013, kërkesë për informacion kërkon informacion Komunës Shënkoll për sipërfaqen e tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991, numri i frymëve me datë 01.08.1991, certifikatën e gjendjes familjare sipas gjendjes civile me datë 01.08.1991 dhe normën për frymë si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesës. Me shkresën nr. 713, datë 23.12.2013 Komuna



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Shënkoll kthen përgjigje se shtetasja R. Gj. Gj. (M.) është banore e fshatit Shënkoll dhe se familja e e saj me datë 01.085.1991, ka qenë me 5 anëtarë ku kryefamiljarë është Gj. M. M.

Familja Mardedaj është pajisur me tokë në fshatin Shënkoll, sipas AMTP nr. 11139, datë 20.02.1992 me sipërfaqe 14221 m² me normën për frymë 3200 m². Komuna Shënkoll ka lëshuar AMTP nr. 14687, datë 22.01.2001 në pronësi të znj. R. Gj. Gj. me sipërfaqe 2000 m², në fshatin Gryk Lumi Komuna Shënkoll, me pretendimin se familja e Gj. M. M. ka marrë tokë me bonitet të ulët duke, përfituar më shumë **221 m²** (16221 m²-16000 m²), këto toka nuk ndahen si toka bujqësore, pasi janë toka pa fryt (**PF**). Ndërsa trajtimi sipas pikës 5, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar, kemi të bëjmë me toka mbi ujë por që nuk janë toka PF pasi këto toka nuk janë ndarë me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, të ndryshuar.

Sa më sipër komisioni vendor, **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të** Aktit të Marrjes së tokës në pronësi të znj. R. Gj. Gj. me nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m² lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të** Aktit të Marrjes së tokës në pronësi të znj. R. Gj. Gj. me nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m² pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshatin Gryk Lumi, ka ndarë tokë pa fryt (PF), e cila nuk ka qenë objekt i ligjit për tokën, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Gryk Lumi, **ka tejkalluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë më shumë se norma për frymë, kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi E. G., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 22.02.2016 dhe B. Z. me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 120, datë 07.02.2013;

Me kërkesë nr. 2795/1, datë 21.11.2013 të ZVRPP Lezhë, ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin e ligjshmërisë të AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe 44900 m²; pasuria nr 41/25, volumi 1, faqe 123, zk. 1099, me sipërfaqe 34800 m² dhe pasuria nr 41/26, volumi 1, faqe 123, zk. 1099, me sipërfaqe 10100 m², lëshuar në emër të N. P. L., fshati Barbullonjë, Komuna Shënkoll, për arsye se shtetasi N. P. L. në favour të cilit është lëshuar AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe 44900 m² nuk ka qenë me banim në fshatin Barbullonjë Komuna Shënkoll dhe sipas certifikatës së datës 01.08.1991 që ndodhet në dosje rezulton të jetë banorë në Rrëshen, AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe 44900 m² nuk është e depozituar në arkivin e ZVRPP Lezhë dhe sipërfaqja e tokës rezulton të jetë dhënë mbi normën për frymë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 120, datë 07.02.2014** dhe ka vendosur rikonfirmimin e e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6093, datë 08.05.1997, **me sipërfaqe 44900 m²**; pasuria nr 41/25, volumi 1, faqe 123, zk. 1099, me sipërfaqe 34800 m² dhe pasuria nr 41/26, volumi 1, faqe 123, zk. 1099, me sipërfaqe 10100 m², lëshuar në emër të N. P. L., fshati Barbullonjë, Komuna Shënkoll.

Sipas dokumentacionit në dosje Komisioni Vendor, me shkresë nr. 1191/1, datë 25.11.2013 me anë të së cilës kërkon informacion Komunës Shënkoll për sipërfaqen e tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991, numri i frymëve me datë 01.08.1991, certifikatën e gjendjes familjare sipas gjendjes civile me datë 01.08.1991 dhe normën për frymë si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesës. Me shkresën nr. 717, datë 26.12.2013 Komuna Shënkoll kthen përgjigje se familja e N. P. L. është pajisur me tokë në fshatin Barbullonjë, me normën për frymë 3700 m², numri i frymëve sipas certifikatës së gjendjes civile bashkangjitur shkresës së përgjigjes me datë 01.08.1991, është 9 frymë ku kjo certifikatë është lëshuar nga zyra e gjendjes civile **Rrëshen, pra kjo familje nuk është banore e Komunës Shënkoll.**

Sa më sipër komisioni vendorë, **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit** të AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, **me sipërfaqe 44900 m²**; pasuria nr 41/25, volumi 1, faqe 123, zk. 1099, me sipërfaqe 34800 m² dhe pasuria nr 41/26, volumi 1, faqe 123, zk. 1099, me sipërfaqe 10100 m², lëshuar në emër të N. P. L., fshati Barbullonjë, Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe 44900 m², lëshuar në emër të N. P. L., fshati Barbullonjë, Komuna Shënkoll, pasi nuk ka qenë punonjës në ish-ndërmarrjes bujqësore me datë 01.10.1992,** veprim në papajtueshmëri me pika 3, nenin 8 dhe pika 1, neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Gryk Lumi, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë për familje të cilat nuk kanë qenë banorë të ish-kooperativës bujqësore, më 1.8.1991 ose punonjës i ish-ndërmarrjes bujqësore me datë 01.10.1992, kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit,** ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Barbullonjë, Komuna Shënkoll,** veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish specialist në komisionin vendor për vlerësimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri më 14.03.2014 dhe B. Z. me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 123, datë 06.10.2014;

Me kërkesë nr. 3212, datë 15.07.2014 të ZVRPP Lezhë, ka kërkuar nga komisioni vendor verifikimin vlefshmërisë të AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe 5003 m²; parcela nr 11/32, arë me sipërfaqe 4883 m² dhe truall me sipërfaqe 120 m² lëshuar në emër të L. Gj. N., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Komision vendor me **vendim nr. 123, datë 06.10.2014** dhe ka vendosur rikonfirmimin e e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe **5003 m²**; parcela nr 11/32, arë me sipërfaqe 4883m² dhe truall me sipërfaqe 120 m² lëshuar në emër të L. Gj. N., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll.

Sipas dokumentacionit në dosje Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë me shkresë nr. 1556/1, datë 24.07.2014 me anë të së cilës kërkon informacion Komunes Shënkoll për sipërfaqen e tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991, numri i frymëve me datë 01.08.1991, për ish- kooperativat bujqësore, apo 01.10.1992 për ish-ndërmarrjet bujqësore, norma në m² për frymë si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesës. Me shkresë nr. 588/1, datë 18.08.2014 Komuna Shënkoll kthen përgjigje se shtetasja L. Gj. N. është pajisur me tokë në fshatin Gryk Lumi me sipërfaqe 5003 m² , norma e tokës e ndarë për frymë për NB ka qenë 3700 m² dhe konfirmon se kjo shtetase është pajisur mbi normën për frymë për 1303 m², pasi parcela me nr 11 është me përqendrim të lartë kripe dhe nuk ka sistem vaditje.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, me shkresë me numër Extra, datë 03.06.2014, konfirmon se L. Gj. N., ka punuar në Ndërmarrjen NFP Rubik sektori Grykë –Lumi, Tale nga data 01.08.1989 deri me datë 31.12.1991.

Zyra e gjendjes Civile Shënkoll, me shkresë nr. 218, datë 09.08.2014, konfirmon se shtetasja L. Gj. N. është vendosur në Komunën Shënkoll fshati Fryk Lumi nëpërmjet martesës me datën 05.04.2002 dhe është vendosur në familjen e B. N. N. i vendosur ky i fundit në Gjendjen Civile Shënkoll me datë 07.05.1996.

Bashkangjitur shkresës së përgjigjes së Komunës Shënkoll ndodhet certifikata e gjendjes **Civile Rubik** ku shtetasja L. Gj. N. (N.) me datë 01.08.1991, është pjesëtare e kësaj familje pra nuk është banore e fshatit Gryk Lumi Komuna Shënkoll.

Sa më sipër komisioni vendor, **nuk duhet të kishte dalë me vendim rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit** të AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe **5003 m²**; parcela nr 11/32, arë me sipërfaqe 4883m² dhe truall me sipërfaqe 120 m² lëshuar në emër të L. Gj. N., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, **por duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe 5003 m²**, lëshuar në emër të L. Gj. N., fshati Gryk Lumi, Komuna Shënkoll, **pasi nuk ka qenë punonjës në ish-ndërmarrjes bujqësore me datë 01.10.1992**, veprim në papajtueshmëri me pika 3, nenin 8 dhe pika 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Gryk Lumi, **ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë për familje të cilat nuk kanë qenë punonjës në ish-ndërmarrjes bujqësore, më 01.10.1992.** Pajisja me tokë bujqësore dhe dhënien e titullit të pronësisë (AMTP), **kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit,** ndërsa komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, **që ka detyrimin ligjor, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Barbullonjë, Komuna Shënkoll,** veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Zaja me detyrë Drejtore i komisionit vendor për periudhën 01.01.2013 deri më 02.02.2016.

- Dosja e vendimit nr. 143, datë 30.11.2016;

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, me shkresë nr. 5309/1, datë 08.10.2015, ka kërkuar konfirmimin e ligjshmërisë të AMTP nr. 14696, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 9000 m², e llojit arë, fshati Gryk Lumi, lëshuar në emër të M. N. N.

Komisioni vendor i vlersimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, shqyrtimin e kërkesës e ka bërë me datë 03.11.2016, **pra 315 ditë me vonë** se kërkesa e ardhur nga qytetari, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Sipas procesverbalit nr. 1, datë 30.11.2016, komisioni vendor ka marrë në shqyrtim kërkesën e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, nga grupi i punës Gj. N., K. M., P. H. kanë propozuar miratimin e Projektvendimit nr. 143, datë 30.11.2016, si dhe është miratuar edhe nga A. P. me detyrë Drejtor dhe Xh. G. me detyrë anëtarët e komisionit vendor.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se në dosje **nuk ndodhet informacioni përmbledhës** për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me shkresë nr. 1572/2, datë 15.02.2016, i ka kërkuar Bashkisë Lezhë, Njësisë Administrative Shënkoll, dokumentacioni në lidhje me sipërfaqen e tokës bujqësore të vënë në dispozicion për tu ndarë me datë 01.08.1991 apo me datë 01.10.1992, për familjen e M. N. N., fshati Grykë -Lumi, certifikatën e gjendjes familjare me datë 01.08.1991 apo me datë 01.10.1992, normën për fryme të tokës bujqësore që është shpërndarë në fshatin Gryk-Lumi me datë 01.08.1991 apo me datë 01.10.1992.

Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Shënkoll me shkresë nr. 9564, datë 06.05.2016, konfirmon se në M. N. N. (familja e tij) është vendosur në fshatin Grykë-Lumi me datë 07.05.1996, dhe është pajisur me tokë bujqësore sipas AMTP nr. 14696, datë 29.01.2001 me sipërfaqe 9000 m² gjithashtu, **kjo pasuri nuk ka sistem vaditje pasi ka përqendrim të lartë kripe.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Kjo familje ka marrë tokë bujqësore edhe me AMTP nr. 3560, datë 27.05.2005 me sipërfaqe 2000 m² dhe me AMTP nr. 3560/1, datë 12.12.2005 me sipërfaqe 483 m², pra ka përfituar gjithsej **11483 m²** tokë bujqësore. **Norma e tokës e ndarë për frymë në fshatin Grykë Lumi është 4300 m².**

Instituti i Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, me shkresë pa numër dhe datë 14.09.2015, konfirmon se M. N. N., lindur në Xhuxhë të Rrethit Mirditë, ka punuar në Ndërmarrjen NFR Rubik sektori Grykë–Lumi, Tale me profesion punëtor nga data 01.10.1990 deri me datë 31.12.1992.

Sipas certifikatës familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Shënkoll, familja e M. N. N. është vendosur në fshatin Grykë-Lumi është me datë 07.05.1996, ndërsa sipas certifikatës së gjendjes civile me datë 01.10.1992 kjo familje ka qenë me banim në fshatin Xhuxhe Mirditë, ku duhet të ketë marrë tokë bujqësore si familje në ish-kooperativën bujqësore.

Komision vendor me **vendim nr. 143, datë 30.11.2016**, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ZVRPP Lezhë, si të pa bazuar në prova dhe ligj dhe rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14696, datë 22.01.2001, me sipërfaqe **9000 m²** tokë bujqësore, fshati Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, për pasurinë nr. 11/2/24.

Sa sipër, komisioni vendor nuk ka argumentuar në mënyrë ligjore rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 14696, datë 22.01.2001, me sipërfaqe **9000 m²** tokë bujqësore, pasi në rubrikën “Fakte mbi të cilat mbështetet kërkesa”, nuk janë përfshirë AMTP nr. 3560, datë 20.09.2005 dhe AMTP nr. 3560/1, datë 12.12.2005, si dhe **nuk ka bërë një hetim të plotë administrativ për familjen e M. N. N. e cila ka ardhur në fshati Grykë-Lumi me datë 07.05.1996.**

Komisioni vendor nuk ka kërkuar nga ZVRPP Mirditë, nëse familja e M. N. N. është pajisur me tokës bujqësore, pasi me datë 01.08.1991 ka qenë me banim në fshatin Xhuxhe, Mirditë.

Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Shënkoll, konfirmon **se toka është me përqendrim të lartë kripe**, këto toka nuk ndahen si toka bujqësore pasi janë toka inpriduktive (PF) dhe nuk kanë qenë objekt i ligjit nr. 7501 “Për tokën”, të ndryshuar.

Gjithashtu, komisioni vendor nuk ka marrë në shqyrtim AMTP nr. 3560, datë 27.05.2005 me sipërfaqe 2000 m² dhe AMTP nr. 3560/1, datë 12.12.2005 me sipërfaqe 483 m², lëshuar në emër të M. N. N., por ka bërë rikonfirmimin e AMTP nr. 14696, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 9000 m² tokë bujqësore, e si pasoj komisioni vendor vendimin këtë vendim e ka marrë në **tejkallim të kompetencave ligjore, që kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e interesave të shtetit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 8 pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor, Gj. N., K. M. dhe P. H. me detyrë anëtar të komisionit vendor.

Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. P., me detyrë Drejtor, Gj. N., K. M. dhe P. H. me detyrë anëtar të komisionit vendor.

7.4 - Auditimi i kërkesave të paraqitura në KV nga individët dhe institucionet dhe të kontrolleve të drejtpërdrejta me nismën e vet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Për periudhën objekt auditimi, është ngritur dhe funksionon struktura e KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut, me 5 vetë, 1 drejtor dhe 4 specialist.

Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi KVVTP-së i janë drejtuar **561 kërkesa** (Nga individë 330 kërkesa, ZVRPP Lezhë 88 kërkesa, ZVRPP Kurbin 110 kërkesa, ZVRPP Mirditë 3 kërkesa, Nj. Administrative Fushkuqe 9 kërkesa, Nj. Administrative Milot 4 kërkesa, Nj. Administrative Kolsh 1 kërkesa, Nj. Administrative Mamurras 3 kërkesa, Nj. Administrative Shënkoll 3 kërkesa, Nj. Administrative Zejmen 1 kërkesa, Nj. Administrative Dajç 1 kërkesa, Bashkia Kurbin 2 kërkesa, Bashkia Rrëshen 1 kërkesë dhe Prokuroria 5 kërkesa), për shqyrtim dhe vlerësim ligjor në përmbushje të funksionit dhe tagrave ligjore që i jep ligji nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar

Për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015, KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut Lezhë i kanë ardhur **441 kërkesa** për të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë 23 vendime ose **5.2 % e këtyre kërkesave** dhe për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2016, KVVTP-së pranë Prefektit të Qarkut Lezhë i kanë ardhur **120 kërkesa** për të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë 18 vendime ose **15 % e këtyre kërkesave**. Nga auditimi konstatohet se ka kërkesa të cilat janë paraqitur që nga momenti i krijimit të KVVTP-së të cilat nuk kanë marrë një përgjigje apo nuk janë trajtuar nga komisioni, duke sjellë mospërmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe në ligjin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, i cili detyron institucionin publik që të trajtoj dhe kthej përgjigje kërkuarit mbi procedimin administrativ të iniciuar **brenda afatit 3 mujor të përcaktuar në nenin 49** “Kufij të përgjithshëm kohorë për përfundimin e procedimit” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “K. Procedurës Administrative”, të ndryshuar (ligj në fuqi për periudhën objekt auditimi) dhe Vendimi i KQT nr. 1, datë 27.03.2009 “Për miratimin e rregullores për organizmin dhe funksionimin e KVVTP”. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. A. P. me detyrë Drejtor i KVVTP-së për periudhën 15.02.2016 e në vazhdim, znj. B. Z. me detyrë Drejtor i KVVTP-së për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016 dhe z. N. I. me detyrë ish Drejtor i KVVTP-së për periudhën 01.01.2013 deri me 05.04.2013.

Nga auditimi mbi kontrollet e drejtpërdrejta të ushtruar me nismën e vet, për periudhën janar 2013 deri më 31.12.2016, rezultoi se: me shkresë nr. 69, datë 09.01.2013, KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Lezhë ka dërguar pranë Komisionit Qeveritarë i Tokës Sekretariatit Teknik, programin e punës për veprimtarinë e tijë lidhur me kontrollet e drejtdrejta me nismën e vet për subjektet që do kontrollohen gjatë vitit 2013 si Komuna Shënkoll, Shëngjin, Fush Kuqe, Bashkia Lezhë, Bashkia Laç dhe Komuna Kolsh.

Me shkresë nr. 129, datë 22.01.2014, KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Lezhë ka dërguar pranë Komisionit Qeveritarë i Tokës Sekretariatit Teknik, programin e punës për veprimtarinë e tijë lidhur me kontrollet e drejtdrejta me nismën e vet për subjektet që do kontrollohen gjatë vitit 2014 si Komuna Shënkoll, Shëngjin, Fush Kuqe, Bashkia Lezhë, Bashkia Laç dhe Komuna Kolsh.

Me shkresë nr. 184, datë 26.01.2015, KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Lezhë ka dërguar pranë Komisionit Qeveritarë i Tokës Sekretariatit Teknik, programin e punës për veprimtarinë e tijë lidhur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

me kontrollet e drejtdrejta me nismën e vet për subjektet që do kontrollohen gjatë vitit 2015 si Komuna Shënkoll, Shëngjin dhe Fush Kuqe.

Për vitin 2016, KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka dërguar pranë Komisionit Qeveritarë i Tokës Sekretariatit Teknik, programin e punës për veprimtarinë e tij lidhur me kontrollet e drejtdrejta me nismën e vet.

Për periudhën objekt auditimi rezulton se KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Lezhë **nuk ka** ushtruar kontroll me nismën e vet dhe nuk ka marrë asnjë vendim në përmbushje të detyrimeve që përcaktohen në gjurmën b, pika 2, neni 7 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

KVVTP pranë Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka ndërtuar një databazë me të dhëna për sipërfaqet e ndara me AMTP për ish NB e Qarkut Lezhë dhe zonave të zhvillimit me përparësi të turizmit, veprim në papajtueshmëri me gjurmën b, pika 2, neni 7 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi: A. P. me detyrë Drejtor i KVVTP-së për periudhën 15.02.2016 e në vazhdim, B. Z. me detyrë Drejtor i KVVTP-së për periudhën 05.04.2013 deri me 05.02.2016 dhe N. I. me detyrë ish Drejtor i KVVTP-së për periudhën 01.01.2013 deri me 05.04.2013.

8. Të ndryshme.

- Mbi auditimin në lidhje me ankesën e ardhur nga Gj. Ll., banues në Lagjen “Zef Hoti”, Njësinë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit Tiranë, nga Gj. Ll., Lagja “Z. H.”, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, ka ardhur Ankesa nr. 411, datë 12.04.2017, në lidhje me AMTP nr. 608, Gusht 1993, me sipërfaqe 6519 m² dhe AMTP nr. 179, pa datë, me sipërfaqe 2600 m² fshati Mamurras.

Gj. Ll. me kërkesë datë 10.06.2014, ardhur në Institucioni e prefekti me nr. 1229, datë 10.06.2014, i është drejtuar Komisioni vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, konfirmimin ligjore të AMTP nr. 608, Gusht 1993, me sipërfaqe 6519 m² dhe AMTP nr. 179, pa datë, me sipërfaqe 2600 m² fshati Mamurras, ish-NB Frutore.

Gj. Ll. me kërkesë datë 12.04.2014, i është drejtuar edhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me këtë çështje, për të cilën Kryeministri me shkresë nr. 3029-4/13, datë 28.04.2014, ka kërkuar nga ZQPP të Shqipërisë, nga Ministri i Drejtësisë, Prefektit të Qarkut Lezhë dhe Këshillit të Qarkut Lezhë, për shqyrtimin dhe përfundimin e veprimeve në lidhje me këtë kërkesë.

Në lidhje me ankesën e ardhur në KLSH nga Gj. Ll., nga grupi i auditimit u kërkuar dosja përkatëse dhe rezultoi se Komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, është hartuar dosja me dokumentacionin përkatës, por nuk ka arritur të marrë vendimin përkatës në lidhje me këtë kërkesë, e si pasoj shqyrtimi i kërkesës e cila ka ardhur me datë 10.06.2014, nuk është bërë, **pra deri me datë 05.05.2017, rezulton që afati ligjore është tejkaluar me 900 ditë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi B. Z., me detyrë Drejtor e komisionit vendor larguar nga detyra me datë 02.02.2016 dhe A. P. me detyrë Drejtor i komisionit vendor në vazhdim.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Gjithashtu, në lidhje me kërkesën e ardhur në KLSH, u me datë 03.05.2017, u zhvillua një takim në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë me Z. Gj. Ll. dhe A. P. me Drejtorin e KV. Nga takimi dhe verifikimi i dokumentacionit në dosje rezultoi se komisioni vendor ka kërkuar nga institucionet përkatëse informacion në lidhje me kërkesën e Gj. Ll. dhe pasi nga institucionet përkatëse janë kthyer përgjigjet në lidhje me këtë çështje u kërkuar dhe u ra dakord që komisioni të marrë na shqyrtim këtë çështje dhe të dal me vendim përkatës, për ti hapu rrugë të drejtës së animimit në gjykatë.

Sa kohë që nga komisioni vendor nuk është marrë një vendi në lidhje me këtë kërkesë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nuk mund të veprojnë në lidhje me këtë çështje.

Për përmirësimin e punës për të ardhmen rekomandojmë si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor për verifikimin e titujve të pronësisë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, procesverbalin e mbledhjeve nuk e ka mbajtur në një libër të sekretuar me numër fletësh të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës, por procesverbalin e ka mbajtur në fletë të shkëputura. Në procesverbal **nuk janë regjistruar problemat e trajtuar nga relatori i çështjes, nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni**, veprim në papajtueshmëri me nenin 16 pika 4, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“ dhe germën a, b pika 6, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 30-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, që për të ardhmen procesverbalin e mbledhjeve ta mbaj në një libër të sekretuar me numër fletësh të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës, si dhe të **regjistroj problemet e trajtuar nga relatori i çështjes dhe diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni.**

Në vijimësi

2 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për **6 vendime** me sipërfaqe **37346 m²**, **nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë**, ndaj anëtarëve të komisioneve të ndarjes së tokës të fshatrave, pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, të cilët kanë sjellë, me efekt dhe dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në faqen 32-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të bëjë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, të cilët pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, që kanë sjelle, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë.

Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

3 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për **32 raste**, nuk ka hartuar informacionin përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuar në lidhje me vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 - Rekomandim: Vendimarrja e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë të jetë e shoqëruar me informacion përmbledhës dhe të jëtë i qartë.

Në vijimësi

4 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **7 vendime** me sipërfaqe **37346 m²**, nuk ka marrë në dorëzim tokën bujqësore të liruar që përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin, si dhe këtë sipërfaqe toke bujqësore nuk e kanë dorëzuar me procesverbal në Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Lezhë (DAMT), veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë në dorëzim tokën e liruar që përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin, si dhe tokën bujqësore ta dorëzojë me procesverbal në Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Lezhë (DAMT).

4.2 - Rekomandim: Të eliminohen në të ardhmen praktikatat të mos marrjes në dorëzim të tokës bujqësore nga persona fizikë dhe juridik të cilët e kanë përfituar në kundërshtim me ligjin.

Në vijimësi

5 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **32 raste**, nuk ka bërë inventarizimin e dosjeve, si dhe nuk ka përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të bëjë inventarizimin e dokumentacionit në dosje, të përcaktoj sasia e fletëve që ndodhen në dosje, si dhe të përcaktohet dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim të tyre.

Në vijimësi

6 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë në **33 raste**, shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore i ka bërë jashtë afatit ligjor, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

6.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, të marrë masa, që shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore ti bëjë brenda afatit ligjor.

Në vijimësi

7 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **5 raste**, nuk ka kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, në lidhje me përfituesit e tokës bujqësore nëse me datë 01.08.1991 kanë qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 kanë qenë punonjës në ish-NB, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin.” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të kërkojë konfirmim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë, në lidhje me përfituesit e tokës bujqësore nëse me datë 01.08.1991, kanë qenë anëtar në ish-kooperativën bujqësore apo me datë 01.10.1992 kanë qenë punonjës në ish-NB.

Në vijimësi

8 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim **nr. 108, datë 02.09.2013**, ka bërë korrigjimin e AMTP nr. 17, datë 01.02.1992, duke kaluar në pronësi të qytetarit Gj. L. pasurinë nr. 19/12-A me sipërfaqe **1050 m²** tokë bujqësore, **pasi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë**, nuk është kthyer përgjigje nëse Gj. D. L., ka qenë punonjës në ish-kooperativën bujqësore apo në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, veprim në papajtueshmëri me nenin 16, të ligjit të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua, me pikën 2, të VKM nr. 255, datë 02.008.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe kreu IV pika 6, të UKM nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin **nr. 108, datë 02.09.2013**, për korrigjimin e AMTP nr. 17, datë 01.02.1992, për pasurinë nr. 19/12-A me sipërfaqe **1050 m²** tokë bujqësore dhe të kërkoj **nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Lezhë**, nëse përfituesi i tokës bujqësore me datë 01.08.1991, ka qenë anëtar në ish-kooperativë bujqësore apo me datë 01.10.1992 ka qenë punonjës në ish-Ndërmarrjen Bujqësore.

Menjëherë

9 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **vendimin nr. 137, datë 18.10.2016**, nuk ka trajtuar zërin kadastral truall me sipërfaqe **200 m²** në emër të qytetarit V. L. H., fshati Ishull-Shëngjin.

- Komisioni vendor nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfituar në kundërshtim me ligjin V. L. H., arkëtimin e vlerës **393,813 lekë, që përbën të ardhura të munguar për buxhetin e shtetit.**



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

Komisioni vendor nuk ka bërë një hetim administrativ të plotë për zërin kadastral truall me sipërfaqe 100 m², si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **627,000 lekë**, nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë të përfitur në kundërshtim me ligjin të qytetarit Gj. K. N., Komisioni vendor me vendim nr. 125, datë 12.03.2015, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **1,343,000 lekë** nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfitur në kundërshtim me ligjin D. C., fshati Grykë Lumi, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë;

- Komisioni vendor me vendim nr. 126, datë 12.03.2015, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **3,439,028 lekë** nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfitur në kundërshtim me ligjin nga M. P. L., fshati Ishull-Lezhë, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë;

- Komisioni vendor me vendim nr. 126, datë 12.03.2015, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **3,443,926 lekë** nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfitur në kundërshtim me ligjin nga V. P. L., fshati Grykë Lumi, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, veprim në papajtueshmëri me germën a neni 1, të ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar dhe nenin 2 pika 2 dhe nenin 9 pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 56-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës:

- **393,813 lekë**, nga V. L. H., fshati Ishull-Shëngjin;
- **627,000 lekë**, nga Gj. K. N., fshati Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll;
- **1,343,000 lekë**, nga D. C., fshati Grykë Lumi, Njësia Administrative Shëngjin;
- **3,439,028 lekë**, nga M. L., fshati Ishull-Lezhë, Njësia Administrative Shëngjin;
- **3,443,926 lekë** nga V. P. L., fshati Grykë Lumi, Njësia Administrative Shëngjin.

Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. **137, datë 18.10.2016**, për sipërfaqen 200 m² i cili me datë 01.08.1991, ndodhet në zërin kadastral “Truall” brenda vijës kufizuese të fshatit Ishull-Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës.

Menjëherë

10 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në pikën 2 të vendimit nr. 140, datë 05.11.2016, për pasurinë nr. 13/36 A me sipërfaqe 5728 m² e cila kalon në pronësi shtet, përfitur më shumë se norma për frymë në AMTP nr. 10133, datë 01.06.1995, duhet të ishte shprehur në fshatin Tale 1, ndërsa për AMTP nr. 14473, datë 21.01.2002, me sipërfaqe 3000 m², duhet të ishte shprehur në fshatin Grykë Lumi, veprim në papajtueshmëri me nenin 2 pika 2, nenin 8 pika 2 dhe nenin 9 pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, (*Trajtuar më hollësisht në faqen 66-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 140, datë 05.11.2016, pasurinë nr. 13/36 A me sipërfaqe **5728 m²** në pronësi shtet në lidhje me AMTP nr. 10133, datë 01.06.1995, fshati Tale 1, ndërsa për AMTP nr. 14473, datë 21.01.2002, në fshatin Grykë Lumi.



Menjëherë

11 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 104, datë 29.05.2013, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997 me sipërfaqe 17981 m² lëshuar në emër të T.P. Gj., fshati Gryk Lumi, pasi ZVRPP Lezhë ka konfirmuar se për këto pasuri KLSH ka rekomanduar kufizimin e tyre, si dhe me AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997, T. P. Gj., **ka përfituar tokë bujqësore më shumë 5081 m², si tokë me bonitet të ulët.** Këto toka nuk ndahen pasi janë toka pa fryt (PF), veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqen 74-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 104, datë 29.05.2013, në lidhje me AMTP nr. 12760, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 17981 m², pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshatin ka ndarë toka (PF), ndërsa për këto pasuri KLSH-ja ka vendosur kufizimi në ZVRPP Lezhë.

Menjëherë

12 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 111, datë 29.05.2013, ka vendosur rikonfirmim të AMTP nr. 14691, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m² pasi familja e F. P. është pajisur me tokë bujqësore në zbatim të VKM nr. 306, datë 30.06.1994 “Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i Hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Puke”, duke përfituar më shumë **se norma për frymë një sipërfaqe 750 m²**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqen 76-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 111, datë 29.05.2013, pasi ka përfituar tokë bujqësore **750 m²** më shumë se norma për frymë.

Menjëherë

13 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr 112, datë 11.07.2013 ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 13887, datë 30.05.1997, me sipërfaqe 8011 m² lëshuar në emër të N. Rr. Gj.; me vendim nr. 113, datë 11.07.2013, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14690, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m², lëshuar në emër të G. P. F., fshati Gryk Lumi; me vendimin nr. 118, datë 09.09.2013 ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14689, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 3000 m²; lëshuar në emër të N. D. D., fshati Gryk Lumi. Në të gjitha rastet në dosje mungon dokumentacioni tekniko ligjor, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”, (Trajtuar më hollësisht në faqen 78-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 - Rekomandim: Komisioni vendorë i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr 112, datë 11.07.2013, nr. 113, datë 11.07.2013 dhe nr. 118, datë 09.09.2013, **duke plotësuar** dosjen me dokumentacionin tekniko ligjor.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTIT TE QARKUT LEZHE”

14 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 114, datë 26.08.2013, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 3587, datë 30.05.1997 me sipërfaqe 11500 m², lëshuar në emër të T. Ll. J., fshati Grykë-Lumi, duke ndarë **tokë pa fryt (PF)**, si dhe ZVRPP Lezhë ka konfirmuar se për këto pasuri KLSH ka vendosur kufizim, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 80-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 114, datë 26.08.2013, pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshatin ka ndarë toka (PF), si dhe për këto pasuri KLSH-ja ka vendosur kufizimi në ZVRPP Lezhë.

Menjëherë

15 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 119, datë 07.02.2014, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m², lëshuar në emër të Rina Gj. Gj. (M.), fshati Grykë Lumi, Komuna Shënkoll, pasi kjo familje ka përfituar tokë bujqësore më shumë 221 m², duke ndarë **tokë pa fryt (PF)**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 82-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 119, datë 26.08.2013, në lidhje me AMTP nr. 14687, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 2000 m², pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshatin Grykë-Lumi ka ndarë toka fryt (PF).

Menjëherë

16 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 120, datë 07.02.2014, ka vendosur rikonfirmimin e nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe 44900 m², lëshuar në emër të N. P. L., fshati Barbullonjë, Komuna Shënkoll, pasi kjo familje me datë 01.08.1991, ka qenë me banim në Rrëshen, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 84-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 - Rekomandim: Komisioni vendor të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 120, datë 07.02.2014, në lidhje me AMTP nr. 6093, datë 08.05.1997, me sipërfaqe 44900 m², pasi ka përfituar tokë pa qenë banor në fshat me datë 01.08.1991.

Menjëherë

17 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 123, datë 06.10.2014, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002 me sipërfaqe 5003 m², lëshuar në emër të L. Gj. N., fshati Grykë-Lumi, Komuna Shënkoll, pasi me datë 01.08.1991 nuk ka qenë anëtare në ish-kooperativën bujqësore, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 85-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

17.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 123, datë 06.10.2014, në lidhje me AMTP nr. 14772, datë 21.01.2002, me sipërfaqe 5003 m², pasi me datë 01.08.1991 nuk ka qenë anëtare në ish-kooperativën bujqësore.

Menjëherë

18 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor me vendim nr. 143, datë 30.11.2016, ka vendosur rikonfirmimin e AMTP nr. 14696, datë 22.01.2001, me sipërfaqe **9000 m²** tokë bujqësore në fshatin Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll, pasi kjo familje me datë 01.08.1991, ka qenë me banim në fshatin Xhuxhe, Mirëditë. Komisioni vendor nuk ka përfshirë në hetim administrative edhe AMTP nr. 3560, datë 27.05.2005 me sipërfaqe 2000 m² dhe AMTP nr. 3560/1, datë 12.12.2005 me sipërfaqe 483 m², lëshuar në emër të M. N. N., **por ka bërë rikonfirmimin e AMTP nr. 14696, datë 22.01.2001, me sipërfaqe 9000 m² tokë bujqësore**, në tejkallim të kompetencave ligjore, **që kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e interesave të shtetit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 8 pika 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 86-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 143, datë 30.11.2016, me sipërfaqe **9000 m²** tokë bujqësore në fshatin Grykë-Lumi, Njësia Administrative Shënkoll, pasi kjo familje me datë 01.08.1991, ka qenë me banim në fshatin Xhuxhe, Mirditë. Komisioni vendor të përfshijë në hetim administrative edhe AMTP nr. 3560, datë 27.05.2005 me sipërfaqe 2000 m² dhe AMTP nr. 3560/1, datë 12.12.2005 me sipërfaqe 483 m².

Menjëherë

19 - Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor për periudhën 01.01.2013 deri me datë 31.12.2016, për tokat bujqësore të ish-NB dhe për zonat me përparësi turizmi nuk ka ushtruar kontrole të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 89-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 - Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të filloj kontrollin e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, për tokat bujqësore në ish-NB dhe për zonat me përparësi turizmi duke hartuar plane pune përkatëse të miratuara nga Prefekti i Qarkut dhe nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë.

Menjëherë

20 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë për periudhën e auditimit ka marrë 2 punonjës më shumë se organika e komisionit vendore të shqyrtimit të titujve të pronësisë në shuëm 620,913 lekë. Gjithashtu, janë kryer pagesa për vendime të Gjykatës së Apelit pa bërë Rekurs në Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, veprim në papajtueshmëri me pikën **iii** shkronja **a** neni 9, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe kreu III, pika 4, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 14-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



20.1 - Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Lezhë të marrë masa, të nxjerrë urdhër për ndërprerjen e kontratës së punës në lidhje me dy punonjësit e përkohshëm pranë komisionit vendor për verifikimit të titujve të pronësisë, si dhe rekrutimin e punonjësve në punë ta bëjë duke zhvilluar proces të rregullt ligjor dhe me konkurrim.

20.1 - Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë të marrë masa, që për vendimet e Gjykatës së Apeli të bëjë Rekurs në Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Në vijimësi

21 - Gjetje nga auditimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë për vitin 2013-2016, nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv **menaxhimi financiar dhe kontrolli**, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe nuk ka formuluar deklaratat e vizionit dhe misionit të njësisë ku përcaktohen objektivat strategjike afatgjatë.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e Brendshme në zbatim të Urdhrit nr. 13, datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Lezhë”, pasi Rregullorja e Brendshme që është në funksionim është miratuar në vitin 2010 dhe nuk i përshtatet strukturës dhe organikës aktuale të institucionit, veprim në papajtueshmëri me neni 8, 21 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 11-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

21.1 - Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë të marrë masa, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik (GMS), të formulojë deklaratën e vizionit dhe misionit të njësisë, të hartojë rregjistrin e riskut në mënyrë që të identifikohen, me një nivel të ulët të kontrollit të brendshëm.

21.1 - Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë të marrë masa, të hartojë Rregulloren në zbatim të Urdhrit nr. 13, datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Lezhë” duke respektuar parimet e transparencës në administrim.

Në vijimësi

22 - Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në 1 procedura prokurimi me vlerë kontrate **416,666** lekë (me tvsh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 28-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1 - Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, të eliminojë praktikën që çojnë në efektivitet të ulët të prokurimeve për mallra e shërbime. Për të ardhmen Institucioni i Prefektit gjatë planifikimit të fondeve për mallra dhe shërbime procedurat e tenderit të jenë në përputhje me fondet e planifikuara.

Në vijimësi

23 - Gjetje nga auditimi: Nga 14 masa organizative të lëna nga KLSH, janë zbatuar 13 masa dhe është në proces zbatimi një masë për arkëtim e shumës 63,292 lekë nga D. L. në shumën 30,885 lekë, N. L. në shumën 9,144 lekë, A. R. në shumën 13,067 lekë dhe K. R. në shumën 43,112 lekë, (*Trajtuar më hollësisht në faqen 10-11, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTTIT TE QARKUT LEZHE”

23.1 - Rekomandimi: Sektori i Financës në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin në vlerën 96,208 lekë si më poshtë:

- nga D. L. **30,885 lekë**; - nga N. L. **9,144 lekë**; - nga A. R. **13,067 lekë**; - nga K. R. **43,112 lekë**

Menjëherë

B - MASA SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 18, të ligjit nr. 8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, të ndryshuar dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **73,570 lekë, si më poshtë:**

1 - Gjetje nga auditimi: Sektori i financës në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për vitin 2016 ka kryer pagesë për shpenzime për larje mjeti jashtë funksionimit, pasi mjeti nuk është pajisur me leje qarkullimi dhe targa në shumën **35,200 lekë, që përbën dëm ekonomik**, veprim në pajtueshmëri me neni 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe pikën 10, të UMF nr. 30, datë 27.12.2013 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, *(Trajtuar më hollësisht në faqen 22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 - Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Lezhë të marrë masa, duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **35,200 lekë**, nga E. C. me detyrë shofer. Mjeti TIP BMË ardhur me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 376, datë 18.10.2011 “Për transferimin pa pagesë të mjetit BMW për Institucionin e Prefektit Lezhë”, mjete gjendje të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.

Menjëherë

2 - Gjetje nga auditimi: Nga zbatimi i kontratës së punimeve në fakt në tenderin me vlerë 1,538,750 lekë pa tvsh për: “Rikonstruksionin e zyrave të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë”, u konstatuan **diferenca në volume pune të pakryera me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 38,317 lekë** pa t.v.sh nga subjekti “Kthjella” shpk, në kundërshtim me kontratë nr. 590, datë 30.03.2015 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender, *(Trajtuar më hollësisht në faqen 27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1 - Rekomandimi: Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë të marrë masa, të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **38,370 lekë**, nga subjekti “Kthella” shpk.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky “Raport Përfundimtar Auditimi”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI “PËR AUDITIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E E PREFKTIT
TE QARKUT LEZHE”